



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 529 Akti

Nr. 649 Vendimi
Tiranë, më 24.4.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datën 19.4.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Taulant Tafa**, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, përfaqësuar nga av. Rezart Kthupi.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje, provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dëgjoi atë dhe përfaqësuesin e tij ligjor në seancën dëgjimore dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

i. Z. Taulant Tafa është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit të tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

ii. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Taulant Tafa i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine (relatore).

iii. Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar; dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

iv. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues komisionerin Olsi Komici dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

v. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin deklaroi se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.

vi. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Taulant Tafa; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

vii. Në datën 20.3.2023 subjektit të rivlerësimit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave/shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

viii. Trupi gjykues, pas marrjes së provave dhe shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. 3 ka vendosur ta ftojë atë në seancën dëgjimore të datës 11.4.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

ix. Subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Tafa, u paraqit në seancën dëgjimore datë 11.4.2023, ora 13:00 dhe kërkoi kohë shtesë për të mundësuar mbrojtjen e tij ligjore nga av. Rezart Kthupi.

x. Trupi gjykues pranoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit dhe vendosi të shtyjë zhvillimin e seancës dëgjimore, nga data 11.4.2023, ora 13:00, në datën 19.4.2023, ora 13:00.

I. SEANCA DËGJIMORE

xi. Në datën 19.4.2023, ora 13:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 24.4.2023.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

xii. Komisioni, me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të plotë dhe të gjithanshëm, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, kreu veprimet verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit të bërë nga ky subjekt, të dhënat e pasqyruara dhe përfundimet e nxjerra nga kontrolli i kryer nga organet ndihmëse, si dhe dokumentacionin dhe provat shpresore të administruara në dosje.

A. VLERËSIMI I PASURISË

ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin e rivlerësimit, z. Taulant Tafa, ku në përfundim ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive;*
- *ka mosdeklarime ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore (DPV) dhe në atë të rivlerësimit kalimtar (deklarata *Vetting*), të dorëzuara në

ILDKPKI, verifikimit të materialeve shkresore të administruara në këtë dosje dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka rezultuar si vijon:

1. Pasuria e paluajtshme truall dhe banesë dy kate + bodrum + nënçati 101 m²/kati

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

1.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Tafa, e ka deklaruar këtë pasuri të krijuar nga babai, të ndodhur në Elbasan, përfituar nga ai 1/3 me trashëgimi ligjore si trashëgimtar i babait të tij dhe 2/3 me dhurim nga nëna dhe motra të pjesëve takuese në datën 30.9.2011. Vlera e deklaruar e banesës 3.500.000 lekë. Pjesa takuese e subjektit: 100%.

1.2. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Tafa, ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë se trualli është përfituar nga babai me trashëgimi ligjore dhe ndërtesa u ndërtua nga babai, pjesërisht nga të ardhurat familjare dhe nga kredia marrë në “Alpha Bank” në Elbasan.

1.3. Në deklaram të interesave privatë për herë të parë në datën 18.3.2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë pasuri ndërtesë: “*Banesë private në Elbasan, në vlerën 3.3 milionë lekë, me pjesë takuese 1/3*”. Si burim krijimi i ndërtesës u deklarua: (i) puna e prindërve; dhe (ii) puna e subjektit.

1.4. Me aktin e pjesëtimit vullnetar datë 15.1.2002, babai i subjektit të rivlerësimit, i ndjeri Dh. T. , ka përfituar truallin me sip. 200 m², në Elbasan.

1.4.1. Në datën 30.4.2002 është përfituar leja e ndërtimit të objektit 2 kate + bodrum + nënçati, me afat deri në datën 8.5.2003.

1.4.2. Në procesverbalin e kolaudimit të objektit 2 kate + bodrum + nënçati, të datës 8.4.2004, afati i ndërtimit specifikohet deri në datën 8.5.2003 dhe vlera e ndërtimit prej 3.149.982 lekësh.

1.5. Me vërtetimin e datës 7.6.2004, Drejtoria e Urbanistikës në Bashkinë Elbasan ka konfirmuar se objekti 2 kate + bodrum + nënçati, për banesë, është përfunduar konform projektit dhe kushteve urbanistike të miratuara sipas vendimit datë 30.4.2002, të KKRT-së. Leja e shfrytëzimit është miratuar në datën 7.6.2004.

1.6. Në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 14.6.2004, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasit Dh. V. T. pasuria nr. ***, z. k. ***, me sipërfaqe truall 200 m² dhe ndërtesë 2 kat + bodrum + nënçati, me sip. 101 m²/kat.

1.7. Në datën 1.4.2011 subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Tafa, ka përfituar me trashëgimi ligjore 1/3 e kësaj pasurie si trashëgimtar ligjor i babait të tij dhe në datën 30.9.2011 ka përfituar pjesën prej 2/3 të pasurisë nëpërmjet kontratës së dhurimit nga nëna e tij A. T. dhe motra e tij A. N. (T.) të pjesëve të tyre takuese të pasurisë.

1.8. Subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në kohën e plotësimit të deklaramit *Vetting* në emrin e tij me pjesë takuese 100%, pasurinë nr. ***, z. k. ***, truall me sip. 200 m² dhe ndërtesë 2 kat + bodrum + nënçati me sip. 101 m²/kat.

1.9. Mbështetur në dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ ka mospërputhje:

a) Lidhur me kohën e ndërtimit të kësaj pasurie:

- referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në dosjen *Vetting*, kjo pasuri është ndërtuar deri në datën 8.5.2003;
- referuar deklaramit të interesave privatë për herë të parë në datën 18.3.2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri është ndërtuar deri në datën 31.12.2003;
- referuar procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI në datën 7.1.2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se banesa ka filluar të ndërtohet në vitin 1999 dhe ka mbaruar në vitin 2003;
- referuar përgjigjeve të pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Në momentin që kam marrë detyrën (viti 1993) pronari i banesës së vjetër ka qenë babai Dh. T. . Po ashtu, pronar i banesës ekzistuese përfunduar në vitin 2004 ka qenë babai Dh. T. ”.*

1.10. Në deklarin e interesave privatë për herë të parë, në datën 18.3.2004, dhe procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka vetëdeklaruar se ndërtimi ka përfunduar në vitin 2003.

1.11. Në deklarin e interesave privatë për herë të parë, në datën 18.3.2004, nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit detyrime financiare të mbetura pa paguar ndaj shoqërisë ndërtuese gjatë vitit 2004, për ndërtimin e banesës 2 kate + bodrum + nënçati deri në vitin 2003.

1.12. Në deklarimet periodike vjetore nga viti 2004 e në vijim, subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar ndërtim vijues të kësaj banese apo pagim të ndonjë kostoje për vijimin e ndërtimit.

1.13. Komisioni, mbështetur edhe në analizë të dokumentacionit: (i) lejes së ndërtimit datë 30.4.2002; (ii) procesverbalit të kolaudimit; (iii) deklarin të interesave privatë për herë të parë, dorëzuar në datën 18.3.2004; dhe (iv) procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI në datën 7.1.2015 – ka vlerësuar si kohë të ndërtimit të banesës deri në datën 31.12.2003.

1.14. Trupi gjykues, në analizë të provave të mësipërme, ka arritur në konkluzionin se nuk ka asnjë provë që të kundërshtojë përfundimin e arritur nga Komisioni se koha e ndërtimit të kësaj banese ka qenë nga viti 2002 deri në fund të vitit 2003.

b) Lidhur me koston e ndërtimit:

- referuar deklarin nga subjekti në deklaratën *Vetting*, kostoja e ndërtimit ishte 3.500.000 lekë;
- referuar deklarin nga subjekti në deklarin e interesave privatë për herë të parë në datën 18.3.2004, kostoja e ndërtimit ishte 3.300.000 lekë;
- referuar aktvlerësimit të datës 17.9.2004, si pjesë e dokumentacionit për përfitimin e kredisë në “Alpha Bank” sh.a., në datën 24.9.2004, kostoja e ndërtimit dhe truallit ishte 10.880.000 lekë;
- referuar preventivit të shoqërisë ndërtuese hartuar në muajin prill të vitit 2002, kostoja e ndërtimit ishte 3.007.513 lekë;
- referuar procesverbalit të kolaudimit, kostoja e ndërtimit ishte 3.149.982 lekë;
- referuar deklarin për herë të parë të subjektit, kostoja e ndërtimit ishte 3.300.000 lekë;
- referuar kostove të ndërtimit për vitet 2002 – 2003¹, kosto rezultonte vlera 5.237.904 lekë.

1.15. Komisioni, pavarësisht se nga llogaritja referuar në kostot mesatare për ndërtim të banesave të EKB-së për vitet 2002 – 2003, kostoja e ndërtimit do të rezultonte në vlerën 5.237.904 lekë, në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt që garanton të drejtat e palës dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit e objektivitetit, vendosi të konsiderojë në analizë financiare skenarin më favorizues dhe garantues për subjektin e rivlerësimit, duke konsideruar kosto ndërtimi 3.500.000 lekë, deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

1.16. Shuma prej 3.300.000 lekësh u konsiderua si vlera e ndërtimit deri në datën 31.12.2003, sipas deklarin nga subjekti i rivlerësimit të interesave privatë për herë të parë në datën 18.3.2004. Shuma prej 200.000 lekësh, si diferencë ndërmjet vlerës së shpenzuar për këtë pasuri, deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, me atë të deklaruar në deklarin për herë të parë më 18.3.2004, u pasqyrua në analizë financiare si shpenzime të tjera në vitin 2004.

c) Lidhur me burimin e deklaruar të të ardhurave dhe mundësinë financiare

- Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim i pasurisë ndërtesë, ndërtuar nga babai i tij, kanë shërbyer pjesërisht të ardhurat familjare dhe pjesa tjetër kredia e marrë në “Alpha Bank”, dega Elbasan.

¹ Referuar Udhëzimit nr. 3, datë 16.10.2002 dhe Udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave.

- Në deklarinimin e interesave privatë për herë të parë, dorëzuar në ILDKPKI në datën 18.3.2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burim të pasurisë ndërtesë janë: (i) puna e prindërve; dhe (ii) puna e tij.

- Në procesverbalin e mbajtur në datën 7.1.2015, në ILDKPKI, në përgjigje të pyetjes mbi burimin e krijimit të shtëpisë së banimit në Elbasan, subjekti ka deklaruar: *“Burim krijimi janë kursimet familjare dhe puna e babait. Në vitin 1999, me sa mbaj mend, në emrin tim kam marrë edhe një kredi bankare me periudhë 5-vjeçare”*.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhurat e krijuara dhe që kanë shërbyer pjesërisht si burim financiar për ndërtimin e banesës 2 kate + bodrum + çati, në Elbasan, janë krijuar nga të ardhurat e prindërve dhe të ardhurat e mia. Kjo për faktin se edhe gjatë kësaj periudhe kam banuar dhe jetuar së bashku me prindërit (sipas certifikatës familjare gjendja e vitit 2003)”*.

c/1. Lidhur me të ardhurat familjare deklaruar si burim krijimi

1.17. Për të ardhurat familjare të shërbyera si burim krijimi, trupi gjykues iu referua dokumentacionit të administruar nga hetimi dhe atij të depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 2 lidhur me të ardhurat familjare.

1.18. Referuar dokumentacionit, familja e subjektit të rivlerësimit, deri në vitin 2003, në kohën e krijimit të kësaj pasurie, përbëhej nga subjekti dhe prindërit.

1.19. Në bazë të dokumentacionit të administruar, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga puna si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe pedagog rezultojnë 3.712.191 lekë.

1.20. Në bazë të dokumentacionit të administruar, të ardhurat e babait të subjektit nga paga bruto dhe asistencë në vitet 1994 – 1996 rezultojnë në vlerën 149.088 lekë dhe të ardhurat nga pensioni për periudhën 1999 – 2003 në vlerën 347.249 lekë.

1.21. Në bazë të dokumentacionit të administruar, të ardhurat e nënës së subjektit nga paga neto dhe asistencë në vitet 1994 – 1996 rezultojnë në vlerën 89.776 lekë. Referuar dokumentacionit të administruar, nëna e subjektit ka përfituar pension familjar dhe pleqërie pas datës 10.9.2005.

c/2. Lidhur me kredinë e marrë në vitin 2004 në shumën 2.000.000 lekë

1.22. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë ndërtesë edhe kredinë e marrë nga “Alpha Bank” sh.a., dega Elbasan.

1.23. Me kontratë kredie datë 24.9.2004, subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga “Alpha Bank” kredinë në shumën 2.000.000 lekë, me afat 5-vjeçar dhe objekt kreditimi rikonstrukcion banese.

1.24. Referuar informacionit të dhënë nga “OTP Bank” sh.a. (banka përthithëse e “Alpha Bank” sh.a.), kredia në shumën 2.000.000 lekë është disbursuar në llogari të subjektit në datën 28.9.2004 dhe në datën 5.10.2004 është tërhequr *cash* prej tij shuma 1.872.900 lekë.

1.25. Shuma e përfituar nga kontrata e kredisë është tërhequr nga subjekti në datën 5.10.2004, pas përfundimit të ndërtimit të banesës 2 kate + bodrum + nënçati dhe pas regjistrimit të kësaj ndërtese në ZVRPP, regjistrim i cili mban datën 14.6.2004.

1.26. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 në lidhje me kredinë subjekti ka sqaruar se: *“Zbatues i projektit ka qenë “***”, me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin P. K. (me shtetasin P. K. kam lidhje familjare). Duke qenë se familjarisht nuk dispononim shumën që nevojitej për ndërtimin e banesës nga ana e babait Dh. T. dhe subjektit zbatues të ndërtimit (P. K.) është rënë dakord në mënyrë verbale me mirëbesim që shuma totale për ndërtimin e objektit të likuidohej pas kolaudimit e regjistrimit të banesës. Shkaku që kredia në shumën 2.000.000 lekë pranë “Alpha Bank” është marrë në datën 24.9.2004, pas përfundimit të banesës (datë 14.6.2004), lidhet me faktin se banka kërkonte vendosjen e një kolaterali, i cili u vendos*

pikërisht banesa 2 kate + bodrum + çati. Pas miratimit të kredisë është tërhequr shuma e kredisë prej 2.000.000 lekësh, që ka shërbyer për të likuiduar detyrimet e prapambetura ndaj subjektit zbatues të ndërtimit”.

1.27. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale të datës 11.4.2022, në përmbajtje të së cilës shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga z. P. K., deklaroi se kanë rënë dakord në mënyrë verbale dhe në mirëbesim që shuma totale për ndërtimin e objektit do të likuidohet pas përfundimit të banesës.

1.28. Trupi gjykues, referuar sa vijon:

- i) faktit se qëllimi dhe objekti i kreditimit, ishte rikonstrukcioni i banesës;
- ii) faktit se shuma e kredisë u tërhoq *cash* nga subjekti në datën 5.10.2004, pas përfundimit të banesës 2 kate + bodrum + nënçati në vitin 2003 dhe pas regjistrimit në datën 14.6.2004;
- iii) faktit se në deklarin e bërë nga subjekti në deklarin e interesave privatë për herë të parë, dorëzuar në datën 18.3.2004, është deklaruar ndërtimi i kryer dhe vlera e shpenzuar, dhe nuk janë deklaruar detyrime financiare të mbetura pa paguar për ndërtimin e banesës,

– arriti në konkluzionin se rezultoi e provuar nga hetimi administrativ, se kredia e marrë në vitin 2004 nga subjekti i rivlerësimit nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi të kësaj pasurie.

1.29. Shuma prej 1.872.900 lekësh u pasqyrua në analizën financiare si shpenzim i kryer për harkun kohor 5.10.2004 – 31.12.2004, për rikonstrukcion banese, sipas objektit të kreditimit.

1/a. Analiza financiare për krijimin e kësaj pasurie

1.30. Mbështetur në dokumentacionin e administruar, trupi gjykues kreu analizën financiare për evidentimin e mundësisë financiare për ndërtimin e banesës 2 kate + bodrum + nënçati në Elbasan dhe mbulimin e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara deri në fund të vitit 2003.

1.30.1. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për periudhën 1.1.1993 – 31.12.2003, duke rezultuar me një balancë negative prej -1.691.500 lekësh.

1.31 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, për sa duket se:

- Ka mospërputhje në deklarin e subjektit të rivlerësimit lidhur me kohën e ndërtimit, koston, shumën e shpenzuar për ndërtimin e kësaj pasurie të paluajshme. Kredia bankare, e datës 24.9.2004 nuk mund të ketë shërbyer si burim për ndërtimin e kësaj pasurie.
- Ka pamundësi financiare të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij që nga burime të deklaruara dhe dokumentuara të të ardhurave për ndërtimin e banesës dy kate + bodrum + nënçati në Elbasan deri në datën 31.12.2003, blerjen e automjetit tip “****”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara, deklaruar për periudhën 1.1.1993 – 31.12.2003, duke rezultuar me balancë negative -1.691.500 lekë.

1/b. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

1.32 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka sqaruar se: *“Deklarimet e tij në lidhje me të ardhurat për ndërtimin/krijimin e kësaj pasurie kanë ruajtur në rend kronologjik vërtetësinë dhe deklarin e burimeve të financimit.*

Komisioni ka përjashtuar si burim të të ardhurave kontratën e kredisë bankare me “Alpha Bank” në shumën 2.000.000, duke e kufizuar analizën e treguesve financiarë deri në vitin 2003, veprim i cili sjell si pasojë balancën e pretenduar negative në burimet financiare të subjektit në vlerën -1.691.500 lekë. Ky përjashtim nuk merr në konsideratë faktin që procedura e ndërtim/kolaudim/leje shfrytëzimi/regjistrimi është përfunduar në vitin 2004 dhe, për pasojë,

edhe në konceptin kontraktual detyrimet ndaj subjektit ndërtues nuk janë detyrim ligjor të shlyhen përpara dorëzimit të objektit, së paku me lejen e shfrytëzimit të miratuar.

*Në analizën financiare, sipas tabelës, nuk janë përfshirë të ardhurat e disponuara nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. Dh. T. , në Bankën e Kursimeve Elbasan. Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 8.4.2022, të lëshuar nga “Raiffeisen Bank” z. Dh. T. , në datën 4.4.2002, kishte gjendje në llogarinë e tij pranë kësaj banke shumën 1.999.766 lekë. Kjo shumë duhet të shtohet në vlerësimin financiar të përgatitur për subjektin e rivlerësimit, për sa i përket objektit 2 kate + bodrum + nënçati, për të pasur shifrën e plotë të të ardhurave dhe burimeve financiare mbi bazën e të cilave është realizuar ndërtimi i objektit dhe për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit kishte burime financiare të mjaftueshme”.*

1/c. Arsyetimi ligjor/analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.33. Trupi gjykues, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49-50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e depozituara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e subjektit e përfaqësuesit të tij ligjor në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

1/c/a. Lidhur me kohën e ndërtimit

1.34. Dokumentacioni tekniko-ligjor i administruar, provon se godina e banimit ka përfunduar së ndërtuari në vitin 2003. Më konkretisht: (i) leja e ndërtimit datë 30.4.2002; dhe (ii) procesverbali i kolaudimit datë 8.4.2004 – provon ndërtimin e banesës deri në datën 8.5.2003.

1.35. Trupi gjykues vlerësoi se edhe vërtetimi nr. *** prot., datë 7.6.2004, i Drejtorisë së Urbanistikës në Bashkinë Elbasan, sipas të cilit objekti-banesë është përfunduar konform projektit dhe kushteve urbanistike të miratuara për sheshin e ndërtimit dhe studimin urbanistik pjesor, miratuar me vendimin nr. **, datë 30.4.2002, të KKRRT-së, provon se përfundimi i punimeve për objektin-banesë është viti 2003.

1.36. Lidhur me pretendimet e subjektit se bazuar në veprimet kronologjike, si moment i përfundimit të punimeve dhe shlyerjes së pagesave sa i përket me krijimin e pasurisë, duhet marrë viti 2004, trupi gjykues çmon se ky pretendim, jo vetëm vjen në kundërshtim me provat e sipërcituara, por edhe me deklaratimet dhe procesverbalet e mbajtura me subjektin në ILDKPKI, provë bazuar në ligjin nr. 84/2016, referuar të cilave subjekti ka deklaruar: (i) në deklaratimin e interesave privatë për herë të parë, dorëzuar në datën 18.3.2004, *banesë e ndërtuar deri në datën 31.12.2003*; (ii) në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 7.1.2015, *banesa ka filluar të ndërtohet në vitin 1999 dhe ka mbaruar në vitin 2003*.

1.37. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të kundërshtonte faktet e rezultuara nga hetimi administrativ lidhur me kohën e ndërtimit, e cila rezultoi e provuar të ishte deri në vitin 2003.

1.38. Trupi gjykues, në arritjen e këtij konkluzioni, mbajti në konsideratë edhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore, ku ai deklaroi se në aspektin inxhinierik ndërtimi i banesës kishte përfunduar në vitin 2003, ndërsa regjistrimi i saj ishte bërë në vitin 2004.

1.38.1. Në analizën financiare (emërtuar “lëvizja dhe ndryshimi i gjendjes *cash* në vite”), të depozituar nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, është pasqyruar nga subjekti shuma 3.300.000 lekë, e shpenzuar deri në vitin 2003, duke rikonfirmuar investimin për këtë pasuri të paluajtshme të shumës 3.300.000 lekë deri në fund të vitit 2003.

1.38.2. Shpenzimet e mobilimit të deklaruara nga subjekti si të kryera në vitin 2003, provojnë gjithashtu faktin se në vitin 2003 banesa ka qenë e përfunduar dhe kishte filluar mobilimi i saj.

1.39. Trupi gjykues, sa më sipër arsyetuar, arrin në përfundimin se rezulton e provuar nga hetimi administrativ dhe dokumentacioni ligjor se objekti-banesë, ka përfunduar në fund të vitit 2003.

1/c/b. Lidhur me mundësinë financiare për krijimin/ndërtimin e kësaj pasurie

1.40. Trupi gjykues arsyeton se kostot e ndërtimit të kësaj pasurie janë llogaritur dhe vlerësuar, referuar dokumentacionit provues si vijon: (i) preventiv i shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. në prill të vitit 2002, në vlerën 3.007.513 lekë; (ii) shuma prej 3.149.982 lekësh, pasqyruar në procesverbalin e kolaudit të banesës; (iii) deklarimi në deklaratën për herë të parë nga subjekti për vlerën e ndërtimit prej 3.3 milionë lekë; (iv) deklarimi nga subjekti për vlerën e ndërtimit 3.5 milionë lekë nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

1.41. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: *“Sipas edhe dokumenteve bashkëngjitur deklaratës Vetting, banesa 2 kate + bodrum + çati në Elbasan është ndërtuar në bazë të lejes së ndërtimit të KKRT-së Bashkia Elbasan, së bashku me situacionin bashkëngjitur, ku vlera e ndërtimit sipas situacionit është rreth 3.400.000 lekë”*.

1.42. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me vlerën e ndërtimit të banesës, në shpjegimet pas rezultateve referuar shpenzimeve të paraqitura në analizën financiare për periudhën 1993 – 2003, ka përfshirë zërat “shpenzim për blerje pasurie”, “shpenzim taksë leje ndërtimi” dhe “shpenzime për mobilim”, të cilat kapin vlerën rreth 200.000 lekë.

1.43. Për sa u përket nënkategorive/zërave “shpenzim për blerje pasurie”, “shpenzim taksë leje ndërtimi” dhe “shpenzime për mobilim”, të pasqyruara nga Komisioni në analizën paraprake financiare deri në datën 31.12.2003, trupi gjykues arsyeton sa vijon:

1.44. Vlera e shpenzimit/investimit për këtë pasuri në analizën financiare nga Komisioni është vlerësuar në vlerë totale 3.500.000 lekë, referuar deklarimeve të subjektit, dhe kjo vlerë nuk përfshin “vlerat e ...lejes së ndërtimit;...truallit...etj.”.

1.44.1. Trupi gjykues vlerësoi të konsiderojë pretendimin e subjektit mbi reduktimin e shpenzimeve në analizën financiare deri në datën 31.12.2003 në vlerën 77.927 lekë (e përbërë nga shpenzim për taksë leje ndërtimi datë 9.5.2002, në vlerën 61.260 lekë dhe shumën prej 16.667 lekësh për blerje pasurie (pjesë takuese 1/3) nga babai i subjektit me kontratë datë 1.8.2001) dhe rezultati përfundimtar financiar rezulton në balancë negative -1.613.573 lekë.

1.44.2. Për sa i përket shpenzimeve të mobilimit të deklaruara nga subjekti si të kryera në vitin 2003 dhe të pasqyruara në analizë, ato nuk ka si të përfshihen në koston e ndërtimit të banesës.

1.45. Në lidhje me pretendimet e subjektit në prapësimet shtesë, që në analizën financiare të Komisionit nuk janë përfshirë të ardhurat e disponuara nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. Dh. T. , në Bankën e Kursimeve Elbasan, konkretisht të shumës 1.999.766 lekë, gjendje në llogari në datën 4.4.2002, trupi gjykues arsyeton se në analizën tabelare janë përfshirë të ardhurat nga interesat e depozitës në emër të babait në ish-Bankën e Kursimeve dhe të ardhurat e tjera të dokumentuara të familjes deri në datën 31.12.2003.

1.46. Për rrjedhojë janë pasqyruar në analizën financiare të Komisionit të gjitha burimet e ligjshme financiare të dokumentuara për krijim të pasurive (përfshirë edhe të likuiditeteve në llogari bankare) dhe shpenzimet për periudhën 1993 – 2003.

1.47. Përfshirja e likuiditeteve në llogari bankare në të ardhura do të dublonte shumën e tyre, pasi kjo depozitë është krijuar nga të ardhura të deklaruara/pasqyruara një herë në analizë.

1.48. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se këto likuiditete, gjendje në llogari depozitë në emër të babait të subjektit, nuk mund t’i shtohen të ardhurave të dokumentuara të familjes së subjektit dhe as mund të ndikojnë në analizën financiare të familjes deri në datën 31.12.2003.

1.49. Vlera e pretenduar nga subjekti, gjendja në llogari bankare, në të ardhura do të dublonte shumën e tyre çka përjashton përdorimin e tyre si burim i të ardhurave për pagimin e pasurisë.

1.50. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka përjashtuar si burim të të ardhurave kontratën e kredisë bankare me “Alpha Bank” sh.a., në shumën 2.000.000 lekë, trupi gjykues arsyeton si vijon:

1.51. Me kontratën e kredisë datë 24.9.2004, subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga “Alpha Bank” kredinë në shumën 2.000.000 lekë, me qëllim rikonstruksion banese, ku si barrë hipotekore për këtë kredi është vendosur pasuria e paluajtshme ndërtesë 2-katëshe + bodrum + nënçati, hipotekuar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 14.6.2004.

1.52. Referuar të dhënave nga “OTP Bank” sh.a. kredia në shumën 2.000.000 lekë u disbursua në llogari të subjektit në datën 28.9.2004 dhe në datën 5.10.2004 u tërhoq *cash*.

1.53. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ndërtimi i objektit nga shoqëria “****” sh.p.k. është një nga rastet tipike të kontratës së sipërmarrjes, çka nënkupton që subjekti i rivlerësimit, për sa kohë nuk ishte lëshuar leja e shfrytëzimit nga Bashkia Elbasan (lëshuar më 7.4.2004) dhe nuk ishte kryer regjistrimi i objektit në ZVRPP (regjistruar më 14.4.2004), nuk kishte detyrimin që të përmbushte elementin e pagesës së plotë të çmimit të kontratës.

1.54. Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk mban në konsideratë se në çdo rast subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte në deklarimet e interesave periodikë përkatës, shpenzimet e kryera për vitin përkatës dhe detyrimet financiare të mbetura ndaj personave juridikë dhe fizikë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003.

1.55. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën e parë të interesave privatë në datën 18.3.2004 dhe në zbatim të nenit 4, shkronja “dh” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, që parashikon: “[...] Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] brenda datës 31 mars të çdo viti gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare” – subjekti nuk ka deklaruar në detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë detyrim të mbetur për shoqërinë ndërtuese.

1.56. Gjithashtu, nga analizimi i deklaratës periodike të vitit 2004 nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar në të, shlyerje detyrimi ndaj shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. apo ndaj shtetasit P. K.

1.57. Trupi gjykues i dha deklaratës për herë të parë të subjektit, dorëzuar në ILDKPKI në datën 18.3.2004 dhe deklarimit periodik vjetor të vitit 2004, vlerën e provave në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile dhe në analizë të deklarimeve të bëra nga vetë subjekti në këto deklarata, Komisioni çmoi se rezulton e provuar se pagesa për ndërtimin e pasurisë ka përfunduar në vitin 2003.

1.58. Trupi gjykues mban në konsideratë edhe parashikimet e kontratës së kredisë sipas të cilave rezultoi e provuar se ajo është marrë dhe përdorur për rikonstruksion banese.

1.59. Trupi gjykues vlerëson se deklarata noteriale e bërë nga shoqëria ndërtuese dhe përfaqësuesi i saj, z. P. K., lidhur me mënyrën e likuidimit të ndërtimit të banesës, vjen në kundërshtim me provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit.

1.60. Për sa më sipërarsyetuar, duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimet e mbajtura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioni çmon se deklarimi i bërë nga shoqëria ndërtuese, përfaqësuar nga z. P. K., gjatë procesit të rivlerësimit, është konceptuar për të mbështetur deklarimet e subjektit të rivlerësimit në këtë proces.

1.61. Trupi gjykues vlerëson se mbeten të paprovuara dhe të karakterit deklarativ pretendimet e subjektit se kredia ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, pasi shuma e përfituar nga kjo kredi është tërhequr nga subjekti në datën 5.10.2004, pas përfundimit të ndërtimit të banesës 2 kate + bodrum + nënçati dhe regjistrimit të saj në datën 14.6.2004.

1.62. Trupi gjykues mban në konsideratë jo vetëm objektin e kreditimit, por edhe vlerën e dakordësuar mes palëve të ndërtimit, sa ½ e kostove mesatare për ndërtim të banesave të EKB-së për vitet 2002 – 2003 dhe legjitimonte rikonstrukcionin nga subjekti në këtë banesë, mundësuar nëpërmjet kreditimit nga banka e nivelit të dytë.

1.63. Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuar së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit për ndërtimin e banesës dy kate + bodrum + nënçati deri në datën 31.12.2003 ka balancë negative prej -1.613.573 lekësh.

1.64. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e banesës së deklaruar në deklaratën *Vetting* në pronësi të tij prej dy kate + bodrum + nënçati me sip. 101 m²/kati, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

2. Pasuria e paluajtshme “bodrum” me sipërfaqe 194 m²

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

2.1. Në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë për vitin 2004, subjekti ka deklaruar: *“Bodrum me sip. 194 m², i ndodhur në pallatin nr. ***, lagjja “***”, Elbasan, në shumën 14.000.000 lekë, me pjesë takuese ½, datë krijimi të pasurisë 28.2.2005”*.

2.1.1. Në detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti, ka deklaruar kontratë huaje në shumën 6.000.000 lekë, me afat 3-vjeçar, datë 3.3.2005, marrë shtetasit D. D.

2.2. Me kontratën e shitblerjes së datës 28.2.2005 ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi D. D. kanë blerë nga shoqëria “***” sh.p.k. pasurinë “bodrum” me sip. 194 m², në Elbasan, regjistruar me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***.

2.2.1. Në kontratën e shitblerjes është deklaruar dhe nënshkruar nga palët se çmimi i blerjes prej 14.000.000 lekësh është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale, para nënshkrimit të saj.

2.3. Në deklaratën e interesave periodikë vjetorë për vitin 2007 subjekti ka deklaruar të ardhura nga kontrata e dhënies me qira të pjesës takuese të tij prej ½ shtetasit D. D., në shumën 100.000 lekë/muaj, në total për vitin 2007, deklaruar të ardhura nga qiraja vlera 1.200.000 lekë.

2.4. Në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e kësaj pasurie me kontratë shitjeje të datës 27.5.2008, në shumën 200.000 euro (pjesa takuese e tij ½).

2.4.1. Lidhur me të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari private dhe/ose publike, në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *“Të ardhura nga shitja e ½ e bodrumit, sipas kontratës së shitjes së datës 27.5.2008, në vlerën 100.000 euro”*, ndërsa në detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë ka deklaruar *“Shlyerje detyrimi ndaj shtetasit D. D., sipas kontratës së huadhënies datë 3.3.2005, në shumën 6.000.000 lekë”*.

2.5. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara nga shitja e kësaj pasurie, në kundërshtim me sa Ligji nr. 84/2016, në nenin 31 të tij, kërkonte deklarimin e çdo të ardhure të krijuar gjatë periudhës së deklarimit.

2/a/1. Lidhur me kohën e pagimit të çmimit të kësaj pasurie

2.6. Subjekti i rivlerësimit, në pyetësin nr. 3, deklaroi: *“Në kontratën e shitblerjes së pasurisë së llojit “bodrum” në datën 28.2.2005, kemi përcaktuar se vlera e blerjes është 14.000.000 lekë, të cilat janë paguar jashtë zyrës noteriale në gjendjen cash. Në të vërtetë shuma është shlyer duke ndjekur modalitet të ndryshëm nga sa kemi përcaktuar në kontratën e shitjes. Duke qenë se as unë dhe as bashkëpronari tjetër D. D. nuk plotësonim shumën në fjalë nuk kemi mundur të paguanim shumën e plotë prej 14.000.000 lekësh, atëherë kemi rënë dakord me shitësin P. K. që diferenca prej 5.000.000 lekësh të shlyhej pas marrjes së kredisë bankare. Kjo tolerancë e shitësit vinte për shkak të marrëdhënies së mirëbesimit si pasojë e*

lidhjes familjare midis nesh, siç kam sqaruar edhe në pyetësorët e mëparshëm. Kemi rënë dakord që të shlyhet shuma prej 9.000.000 lekësh ditën e nënshkrimit të kontratës në gjendjen cash, e cila është shlyer nga shtetasi D. D. Në lidhje me këtë pasuri nga ana ime nuk është kryer asnjë investim në vijim”.

2.6.1. Deklarimi i mësipërm vjen në kundërshtim me sa në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë për vitin 2004, subjekti ka deklaruar në detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë vetëm kontratë huadhënieje në shumën 6.000.000 lekë lidhur me shtetasin D. D. dhe nuk ka deklarim për detyrim ndaj shoqërisë ndërtuese për pagimin e çmimit.

2.7. Subjekti ka depozituar gjatë hetimit administrativ deklaratën noteriale të datës 11.4.2022, në të cilën përfaqësuesi i shoqërisë ndërtuese, z. P. K., ka deklaruar: *“Në vitin 2004 - 2005 kam ndërtuar pallatin në të cilin ndodhej edhe një pjesë e bodrumit me sip. 194 m², ia kam shitur shtetasve Taulant Tafa dhe D. D. kundrejt shumës 14.000.000 lekë. Fillimisht, në momentin e hartimit të kontratës së shitjes nga blerësit është likuiduar shuma 9.000.000 lekë dhe pas disa muajsh pas marrjes së kredisë kanë shlyer gradualisht të gjithë shumën”.*

2.8. Deklarata noteriale e datës 11.4.2022, e cila referon mënyrën si u pagua çmimi, vjen në kundërshtim me deklaramet e subjektit gjatë deklarameteve periodike, dokumentacionin ligjor hartuar mes palëve, si dhe me procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 7.1.2015, ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Kam paguar 1.000.000 lekë nga kredia e marrë, pjesën tjetër të kredisë e ka shfrytëzuar z. D. për rregullimin e bodrumit, të cilin e ktheu në lokal”.*

2.9. Deklarata noteriale nga shoqëria ndërtuese dhe përfaqësuesi, z. P. K., gjatë procesit administrativ lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit, mbetet në nivel deklarativ.

2/b. Analiza e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

2.10. Në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë për vitin 2004, subjekti ka deklaruar *blerjen e pasurisë së llojit “bodrum” me sip. 194 m², në lagjen “***”, Elbasan, në shumën 14.000.000 lekë, me pjesë takuese ½, datë krijimi të pasurisë 28.2.2005*, por nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave të pjesës së tij takuese, ndërkohë që në detyrime financiare deklaroi *huan pa interes të datës 3.3.2005, në shumën 6.000.000 lekë nga shtetasi D. D.*

2/b/1. Hua nga shtetasi D. D.

2.11. Në bazë të kontratës së huadhënies nr. ***, datë 3.3.2005, subjekti ka marrë një hua pa interes në shumën 6.000.000 lekë nga shtetasi D. D. , për një periudhë 3-vjeçare, me këste kthimi 2.000.000 lekë për çdo vit.

2.12. Në përgjigje të pyetësorit standard, në lidhje me hua të marra nga persona dhe/ose shoqëri private, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk mban mend të ketë marrë ndonjëherë hua nga ndonjë person apo shoqëri private.

2.13. Deklarimi i mësipërm i subjektit gjatë hetimit administrativ vjen në kundërshtim me faktet e deklaruara nga palët në kontratën e huadhënies nr. ***, datë 3.3.2005.

2.14. Me kontratën e huadhënies datë 3.3.2005, subjekti i rivlerësimit ka marrë një hua pa interes në shumën 6.000.000 lekë nga shtetasi D. D. , për një periudhë 3-vjeçare.

2.15. Në deklaratën e interesave periodikë vjetorë për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përfituar *pjesë takuese ½, të bodrumit me sip. 194 m², i ndodhur në Elbasan, blerë në shumën 14.000.000 lekë, datë krijimi të pasurisë 28.2.2005.*

2.16. Në deklaratën e interesave periodikë vjetorë për vitin 2004, në detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti ka deklaruar vetëm kontratë huaje me shtetasin D. D. në shumën 6.000.000 lekë, me afat 3-vjeçar, pa interes, datë 3.3.2005.

2.17. Në deklaratën e interesave periodikë vjetorë për vitin 2008, subjekti ka deklaruar shitjen e kësaj pasurie në shumën 200.000 euro (pjesë takuese ½). Në të ardhurat dhe angazhime në

veprimtari private dhe/ose publike, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar të ardhura nga shitja e ½ e bodrumit, sipas kontratës së shitjes së datës 27.5.2008, në vlerën 100.000 euro.

2.17.1. Në detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë ka deklaruar: “Shlyerje detyrimi ndaj shtetasit D. D. , sipas kontratës së huadhënies datë 3.3.2005, shuma 6.000.000 lekë”.

2.18. Referuar kontratës së shitblerjes datë 28.2.2005, subjekti dhe shtetasi D. D. kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor shtetasin P. K., pasurinë e llojit “bodrum” me sip. 194 m², në Elbasan, kundrejt çmimit të blerjes prej 14.000.000 lekësh, likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

2.19. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, në lidhje me kohën dhe mënyrën e pagesës së çmimit të blerjes, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “Në kontratën e shitblerjes së pasurisë së llojit “bodrum”, në datën 28.2.2005, kemi përcaktuar se vlera e blerjes është 14.000.000 lekë, të cilat janë paguar jashtë zyrës noteriale në gjendje cash. Në të vërtetë, shuma është shlyer duke ndjekur modalitet të ndryshëm nga sa kemi përcaktuar në kontratën e shitjes. Duke qenë se as unë dhe as bashkëpronari tjetër D. D. nuk plotësonim shumën në fjalë, nuk kemi mundur të paguanim shumën e plotë prej 14.000.000 lekësh, atëherë kemi rënë dakord me shitësin P. K. që diferenca prej 5.000.000 lekësh të shlyhej pas marrjes së kredisë bankare”.

2.20. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 7.1.2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Pallati ku është blerë bodrumi është ndërtuar nga burri i vajzës së dajës tim, z. P. K., firma “***”. Kjo është edhe arsyeja që e kemi blerë me çmim tepër të arsyeshëm 70.000 lekë/m². Pjesën time të bodrumit ia dhashë me qira z. D.”.

2.21. Mbështetur në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe në kontratën e huadhënies nr. ***, datë 3.3.2005, subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur që e kanë konfirmuar këtë marrëdhënie, duhet të deklaronin dhe provonin ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës dhënë hua.

2.22. Subjektit i është kërkuar të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e shtetasit D. D. , e dhëna hua subjektit për blerjen prej tij të pjesës takuese prej ½ të bodrumit me sip. 194 m², në Elbasan.

2.23. Subjekti lidhur me të ardhurat e shtetasit D. D. , ka deklaruar se: “Për periudhën para vitit 2005, shtetasi D. D. ka qenë për një periudhë kohe emigrant në shtetin italian dhe në emigracion kishte siguruar edhe të ardhura që u përdorën pjesërisht në blerjen e bodrumit me sip. 194 m², Elbasan. Shtetasi D. D. ka kryer punë “në të zezë”, për mungesë dokumentacioni nuk është regjistruar nga punëdhënësi, ndaj objektivisht është e pamundur të sigurohet dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e siguruara prej tij nga emigracioni në shtetin italian”.

2.24. Gjithashtu, lidhur me të ardhurat e shtetasit D. D. , pas vitit 2005 subjekti deklaroi: “Pas kthimit nga emigracioni për periudhën 2005 e në vazhdim kam dijeni që shtetasi D. D. merrej me aktivitet privat “bar-kafe”, dhe merrej me aktivitet privat “grumbullim të bimëve mjekësore”, aktivitet të cilin e ushtronte së bashku me shtetasin Xh. Sh., me të cilin ai kishte lidhje familjare, i regjistruar që në vitin 1997 në organet tatimore”.

2.25. Subjekti ka depozituar si dokumentacion në funksion të shpjegimeve: (i) ekstrakt regjistrimi nga QKB-ja të subjektit “D. D. ”; dhe (ii) ekstrakt regjistrimi nga QKB-historiku, të subjektit tregtar “****”.

2.26. Në bazë të verifikimit në faqen zyrtare të QKB-së rezulton se D. D. është regjistruar si person fizik (bar-kafe) dhe është pajisur me NIPT në vitin 2005 dhe në datën 12.1.2006 është çregjistruar nga regjistri tregtar.

2.27. DRT Elbasan konfirmoi se për vitin 2005 subjekti “D. D. ” ka deklaruar xhiro të parashikuar 1.200.000 lekë dhe tatim-fitimi i thjeshtuar i paguar ka qenë 36.000 lekë.

2.28. Lidhur me të ardhura të pretenduara nga subjekti për shtetasin D. D. nga aktiviteti i regjistruar në organet tatimore të subjektit tregtar “****”, me administrator shtetasin Xh. Sh., referuar verifikimit në faqen zyrtare të QKB-së, shtetasi D. D. nuk ka qenë asnjëherë pjesë e ortakëve, aksionerëve apo administratorëve të kësaj shoqërie. Në këto kushte, pretendimi mbi të ardhura të shtetasit D. D. nga aktiviteti i subjektit tregtar “****” mbetet i paprovuar me dokumentacion ligjor provues.

2.29. Mbështetur në të dhënat e administruara gjatë hetimit, në lidhje me huan e marrë nga shtetasi D. D. , në shumën 6.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të huadhënësit për shumën e dhënë hua, ndaj dhe kjo hua nuk u përfshi në analizën e treguesve financiarë për krijimin e kësaj pasurie.

2/b/2. Kredia bankare e përfituar nga “Alpha Bank” sh.a.

2.30. Në deklaratën Vetting subjekti e deklaroi këtë kredi si burim krijimi. Në deklarin e interesave privatë të vitit 2005 kjo kredi nuk është deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri.

2.31. Me kontratë kredie nr. ***, datë 21.4.2005, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi D. D. kanë përfituar nga “Alpha Bank” sh.a. kredinë bankare në shumën 5.000.000 lekë.

2.32. Referuar të dhënave bankare rezulton se kredia në shumën 5.000.000 lekë është disbursuar në datën 22.4.2005 në llogarinë e përbashkët të shtetasit D. D. dhe subjektit Taulant Tafa. Në harkun kohor 22.4.2005 – 11.8.2005, nga shuma e kredisë së disbursuar shtetasi D. D. ka tërhequr *cash* në 9 raste shumën 4.529.200 lekë.

2.33. Data e lidhjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë bodrum nga shtetasi D. D. dhe subjekti Taulant Tafa me shoqërinë “****” sh.p.k., ishte rreth 2 muaj para disbursimit të kredisë. Në kontratën e shitblerjes së pasurisë në datë 28.2.2005 palët deklaruan pagimin e shumës prej 14.000.000 lekë, dy muaj para disbursimit të kredisë bankare.

2.34. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 7.1.2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar mbi destinacionin e kredisë bankare se: *“Kam paguar 1.000.000 lekë nga kredia e marrë, pjesën tjetër e ka shfrytëzuar z. D. për rregullimin e bodrumit të cilin e ktheu në lokal”*.

2.35. Referuar dokumentacionit të disponuar, të dhënave për kohën e disbursimit të kredisë, si dhe deklarin e subjektit në ILDKPKI, në datën 7.1.2015, Komisioni ka vlerësuar se rezulton e provuar nga dokumentacioni ligjor provues se kjo kredi nuk mund të ketë shërbyer për pagimin e çmimit të kësaj pasurie të paluajtshme nga shtetasi D. D. dhe subjekti i rivlerësimit.

2.36. Në lidhje me shumën e marrë kredi të përbashkët me kontratën datë 21.4.2005, me shtetasin D. D. në “Alpha Bank” sh.a., për sa më sipër arsyetuar. Komisioni ka vlerësuar se ajo duhet të pasqyrohet në analizën financiare si shpenzim i subjektit shuma prej 2.500.000 lekësh dhe, sa i përket shlyerjes së kësaj kredie ajo duhet të pasqyrohet si shpenzim në analizën financiare për pjesën takuese të kësteve të paguara.

2.37. Referuar të dhënave nga “OTP Bank” sh.a. rezulton se në datën 23.5.2008, në llogarinë e përbashkët në euro në emër të shtetasve D. D. dhe Taulant Tafa është depozituar *cash* shuma 30.800 euro, e cila brenda ditës me konvertim në lekë ka kaluar në llogarinë e përbashkët të kredisë në lekë pranë “Alpha Bank” sh.a., shumë e cila ka shërbyer për shlyerjen para kohe të kredisë në vlerën 5.000.000 lekë (kontratë datë 21.4.2005) pranë kësaj banke.

2.38. Me vërtetimin datë 16.1.2015, “Alpha Bank” sh.a., dega Elbasan, konfirmon shlyerjen totalisht të kësaj kredie në datën 23.5.2008 dhe në datën 27.5.2008 heqjen e barrës siguroese.

2.39. Sa më sipër, depozitimi i shumës 30.800 euro (datë 23.5.2008) për shlyerjen e pjesës së mbetur të kredisë në “Alpha Bank” është kryer përpara se të likuidohej nga blerësi shuma 200.014 euro, si çmim i shitjes së pasurisë bodrum, me sip. 194 m² (kontratë datë 27.5.2008).

2.40. Nisur nga fakti që subjekti nuk ka deklaruar kursime të mbartura deri në datën 31.12.2007, duket se subjekti ka pamundësi për shlyerjen e pjesës së tij takuese në kredinë e mbetur në “Alpha Bank” sh.a. në shumën 15.400 euro (pjesa takuese e shlyerjes së kredisë).

2/b/3. Analiza financiare për blerjen e kësaj pasurie

2.41. Komisioni kreu analizën financiare për harkun kohor 1.1.2005 – 28.2.2005, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e pjesës së tij takuese në pasurinë e paluajtshme, bodrum me sip. 194 m², në datën 28.2.2005.

Analiza e treguesve financiarë për harkun kohor 1.1.2005 – 28.2.2005	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga puna e subjektit në Gjykatën e Rrethit Elbasan për periudhën	129.628
Të ardhura, babai nga pensioni, për periudhën	16.232
Total të ardhura/të hyra financiare	145.860
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për periudhën	52.227
Total shpenzime/të dala financiare	52.227
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim-gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	0
Mjete monetare të disponueshme (1)	93.633
Shpenzime për pagesën e pjesës takuese në pasurinë bodrum (1/2) me sip. 194 m ²	7.000.000
Total pasuri	7.000.000
Detyrime financiare	0
Pasuri neto (2)	7.000.000
Balanca e fondeve (1-2)	-6.906.367

2.42. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor provues burimin e ligjshëm të të ardhurave për pagesën e pjesës së tij takuese në pasurinë bodrum me sip. 194 m², në Elbasan, blerë me kontratë shitblerjeje në datën 28.2.2005, në shumën totale 14.000.000 lekë, duke rezultuar me balancë negative prej -6.906.367 lekësh.

2/c. Në lidhje me shitjen e kësaj pasurie

2.43. Në deklaratën e interesave periodikë vjetorë për vitin 2008, subjekti, ka deklaruar: “*Shitje të një sipërfaqeje bodrumi prej 194 m², ndodhur në z. k. ***, lagjja “***” (kontratë shitjeje nr. ***, datë 27.5.2008, në shumën 200.000 euro, me pjesë takuese 1/2)*”.

2.44. Në të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari private dhe/ose publike, subjekti, ka deklaruar të ardhurat nga shitja e 1/2 e bodrumit, sipas kontratës së shitjes së datës 27.5.2008, në vlerën 100.000 euro, ndërsa në detyrime financiare ka deklaruar shlyerjen e detyrimit 6.000.000 lekë ndaj shtetasit D. D. , sipas kontratës së huadhënies datë 3.3.2005.

2.45. Me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 27.5.2008, subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi D. D. i kanë shitur shtetases H. L., e datëlindjes 14.5.1951, pasurinë e llojit “bodrum”, me sip. 194 m², kundrejt çmimit 200.014 euro.

2.46. Në këtë kontratë palët kanë deklaruar se janë likuiduar totalisht jashtë kësaj zyre noteriale, pasi është marrë në dorëzim pasuria, pa u shfaqur pretendime për gjendjen e saj.

2.47. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Vlera prej 200.000 euro, që i korrespondon çmimit të shitjes së kësaj pasurie, na është dhënë dorazi jashtë zyrës noteriale nga pala blerëse... Kjo pasuri është marrë në dorëzim nga blerësja ditën e lidhjes së kontratës së shitjes në datën 27.5.2008 dhe në datën 20.6.2008 pala blerëse ka bërë regjistrimin e saj në ZVRPP... ”.*

2.47.1. Shpjegimi i subjektit mbi marrjen e të ardhurave dhe destinacionin e të ardhurave prej 100.007 euro, nga shitja e kësaj pasurie, nuk duken bindëse, duke referuar se nuk ka asnjë provë ligjore apo financiare për sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

2.48. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e sa duket se:

- ka pasur pamundësi financiare nga ana e subjektit të rivlerësimit për pagimin e çmimit të blerjes së pjesës së tij takuese në pasurinë bodrum me sip. 194 m², në Elbasan, në datën 28.2.2005, duke rezultuar me balancë negative prej -6.906.367 lekësh;
- ka pasur pamundësi financiare nga ana e subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e pjesës takuese prej 15.400 euro në kreditinë e mbetur në “Alpha Bank” sh.a., në datën 23.5.2008;
- ka mosdeklarim në deklaratën *Vetting* të shumës 100.007 euro, si e ardhur e përfituar nga shitja e pjesës takuese të pasurisë bodrum me sip. 194 m²;
- lidhur me të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie, subjekti duhet të provojë që nuk ndodhet në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

2/ç. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

2/ç/1. Lidhur me kohën e pagimit të kësaj pasurie të paluajtshme

2.49. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, sqaroi se: *“Sipas deklaratës noteriale të lëshuar nga pala shitëse kjo e fundit deklaroi që: “...fillimisht në momentin e hartimit të kontratës së shitjes nga ana e blerësve është likuiduar shuma prej 9.000.000 lekësh dhe pas disa muajsh më kanë shlyer gradualisht të gjithë shumën...”. Nga brendia e deklaratës noteriale të lëshuar nga shtetasi P. K., në cilësinë e shitësit, provohen qartësisht tri fakte: (a) se në momentin e hartimit të kontratës së shitjes, pra me datë 28.2.2005, palët blerëse (përfshirë subjektin e rivlerësimit) kanë shlyer shumën prej 9.000.000 lekësh; (b) pjesa e mbetur prej 5.000.000 lekësh është shlyer gradualisht, jo me një pagesë të vetme, por me pagesa pjesore në kohë të ndryshme; dhe (c) shuma e detyrimit në masën 14.000.000 është shlyer tërësisht”.*

2/ç/2. Lidhur me huan e marrë nga shtetasi D. D.

2.50. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Është e bazuar ligjërisht kërkesa e Komisionit për justifikimin me burime të ligjshme të vlerës prej 9.000.000 lekësh që shtetasi D. D. ka paguar më hartimin e kontratës së shitjes së datës 28.2.2005. Për të provuar mundësinë e burimeve financiare të shtetasit D. D. sjellim në vëmendje të Komisionit deklaratën noteriale nr. 1384/753, datë 10.4.2023, të lëshuar nga shtetasi Xh. Sh., në cilësinë e ortakut të shoqërisë “***” sh.p.k., si dhe familjarit (dajës) të shtetasit D. D. ”.*

2.51. Në këtë deklaratë noteriale shtetasi Xh. Sh. deklaroi se për shkak të marrëdhënies familjare ndërmjet tij dhe shtetasit D. D. i ka dhënë hua këtij të fundit në vitin 2005 shumën prej 6.000.000 lekësh, e cila në dijeninë e tij është përdorur për blerjen e bodrumit prej 194 m² të ndodhur në Elbasan. Gjithashtu, në këtë deklaratë noteriale shtetasi Xh. Sh. deklaroi se pas kthimit nga shteti italian në vitin 2004 shtetasi D. D. është paguar prej tij për hartimin e pasqyrave financiare të subjektit “***” sh.p.k., pavarësisht faktit që nuk është deklaruar si i punësuar në administratën tatimore dhe/apo në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

2.52. Subjekti paraqiti në cilësinë e provës dokumentacionin: (i) deklaratë noteriale nr. ***, datë 17.4.2023, me deklarues shtetasin D. D. , i cili deklaroi: *“Unë i nënshkruari kam qenë në emigrim në shtetin italian, ku kam punuar në mënyrë informale dhe kur jam kthyer rreth vitit 2004 jam punësuar jo në mënyrë të rregullt ligjore pranë shoqërisë “***” sh.p.k., me administrator Xh. Sh., me të cilin kam lidhje familjare”.*

2/ç/3. Lidhur me kreditinë bankare të marrë në “Alpha Bank” sh.a.

2.53. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, lidhur me përdorimin si burim të saj, ndër të tjera, pretendoi sikundër gjatë hetimit se kredia e marrë në “Alpha Bank” sh.a. me vlerë 5.000.0000 lekë u përdor si burim krijimi për këtë pasuri.

Lidhur me shlyerjen e kësaj kredie subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, pretendoi se: *“Përfundimi i arritur nga Komisioni se subjekti nuk kishte mjete financiare të mjaftueshme për të shlyer pjesën takuese të kredisë në vlerën 15.400 euro, me datë 23.5.2008, nuk merr në konsideratë të gjitha elementet e marrëdhënieve juridike ndërmjet bankës, palëve shitëse dhe palës blerëse.*

Në këto kushte, në marrëveshjen me blerësin është marrë paradhënë shuma 30.800 euro, si pjesë e shumës së përgjithshme prej 200.000 euro, e dakordësuar për shitjen e pasurisë bodrum me sip. 194 m². Subjekti i rivlerësimit nuk kishte arsye për të pasur burime të ligjshme, për sa kohë që shlyerja e kredisë përballohej nga një paradhënie e palës blerëse”.

2/ç/4. Lidhur me shitjen e kësaj pasurie

2.54. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, sqaroi se: *“Kontrata e shitjes është akti provues, dokument ligjor që provon jo vetëm që fakti juridik ka ndodhur, por edhe që të dhënat e përcaktuara në kontratë për ndodhjen e faktit juridik janë ato të përshkruara nga palët nënshkruese në kontratë. Kontrata e datës 27.5.2008, si dhe veprimet e mëpasshme për kalimin e pronësisë së sendit provojnë që ndërmjet palëve ka një marrëdhënie juridike për kalimin e pronësisë së sendit, që kjo marrëdhënie është konkretizuar në vlerën 200.000 euro, që kjo vlerë i është paguar shitësve e plotë deri në datën 27.5.2008 dhe se palët me nënshkrimin e kontratës dhe kalimin e pronësisë nuk kanë pasur më asnjë pretendim.*

Për sa kohë që nuk ka një indicie apo fakt që të kontestojë deklaratimet e palëve në kontratën e shitjes së datës 27.5.2008, nuk mund të ngrihen pretendime në lidhje me zbatimin e kontratës. Shuma prej 100.007 euro është shpenzuar duke shlyer detyrimet sipas kontratës së huamarrjes datë 3.3.2004, në vlerën 6.000.000 lekë, detyrimet për pjesën e mbetur të kontratës së kredisë së datës 21.4.2005, në vlerën 15.400 euro dhe pjesa e mbetur prej afro 4.000.000 lekësh është përdorur për shpenzime jetese në periudhën 2008 – 2009”.

2/d. Arsyetimi ligjor/analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.55. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar Vetting; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49-50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e subjektit dhe përfaqësuesit të tij ligjor në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

2/d/1. Lidhur me kohën e pagimit të kësaj pasurie

2.56. Deklarimet e subjektit dhe pretendimet e tij lidhur me kohën e pagimit të kësaj pasurie vijnë në kundërshtim me parashikimet në kontratën e dakordësuar dhe nënshkruar mes palëve.

2.57. Referuar parashikimeve të kontratës së shitblerjes nr. 1273/196, datë 28.2.2005, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi D. D. blenë nga shoqëria “****” sh.p.k. pasurinë e llojit “bodrum” me sip. 194 m², në Elbasan, dhe paguan çmimin prej 14.000.000 lekësh, para hartimit të kësaj kontrate, jashtë zyrës noteriale.

2.58. Në nenin 676 të Kodit Civil parashikohet shprehimisht se kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Pra, palët kur lidhin kontratën duhet të merren vesh për kushtet që duhet të përmbahen në kontratë, për çmimin dhe mënyrën e pagesës.

2.59. Dispozitat e kontratës, që parashikojnë kushtet thelbësore të saj, për çmimin dhe mënyrën e pagesës janë imperative, urdhëruese, kanë forcën e ligjit dhe duhet të respektohen nga palët.

2.60. Deklarimet e subjektit mbi dakordësi të ndryshme në lidhje me mënyrën e pagesës së çmimit të pasurisë nuk provohen, për sa kohë nuk janë pasqyruar në asnjë nga dispozitat e kontratës, ku palët kanë shprehur vullnetin e tyre të pavesuar në lidhje me kushtet thelbësore të kontratës, jo vetëm për çmimin e sendit, por edhe për mënyrën e pagesës së tij.

2.61. Pretendimet e subjektit për mënyrën e pagesës së çmimit nuk mbështeten as nga deklarimi i subjektit në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë për vitin 2005, ku subjekti ka deklaruar blerjen e pasurisë *bodrum me sip. 194 m², në shumën 14.000.000 lekë*, duke mos deklaruar detyrime të mbetura për pagimin e çmimit të pasurisë ndaj shitësit të saj.

2.62. Kontrata është akti provues, dokument ligjor që provon jo vetëm që fakti juridik ka ndodhur, por edhe që të dhënat e përcaktuara në kontratë për ndodhjen e faktit juridik janë ato të përshkruara nga palët nënshkruese në kontratë.

2.63. Kontrata dhe veprimet e mëpasshme për kalimin e pronësisë provojnë që ndërmjet palëve ka pasur një marrëdhënie juridike për kalimin e pronësisë, konkretizuar në vlerën 14.000.000 lekë dhe që kjo vlerë i është paguar shitësve e plotë para nënshkrimit të kontratës dhe palët me nënshkrimin e kontratës dhe kalimin e pronësisë nuk kanë pasur më asnjë pretendim.

2.64. Trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit dhe deklarimet noteriale nga përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.p.k., z. P. K., lidhur me kohën e pagimit të çmimit për blerjen e kësaj pasurie, vijnë në kundërshtim me kontratën e nënshkruar prej tyre.

2.65. Palët kanë pasur mundësitë ligjore të parashikonin në hartimin e dokumentit ligjor të kryerjes së veprimit juridik mes tyre, kontrata e shitjes datë 28.2.2005, të gjitha sa pretendohet e deklarohet gjatë procesit dhe në deklaratën noteriale, fakt që rezultoi të mos ketë ndodhur.

2.66. Trupi gjykues vlerësoi se nuk ekziston asnjë shkak ligjor, që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratën noteriale të lidhur mes palëve, lidhur me kohën e pagimit të çmimit prej 14.000.000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme në datën 28.2.2005.

2/d/2. Lidhur me huan e marrë nga shtetasi D. D.

2.67. Deklarimet e subjektit gjatë hetimit administrativ mbi burimin e ligjshëm të huas nga shtetasi D. D. prej 6.000.000 lekësh, kishin si burim të ardhura nga emigracioni dhe aktiviteti “bar - kafe” dhe punësimi i këtij shtetasi.

2.68. Pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti deklaroi se burimi i huas së marrë nga shtetasi D. D. ishte një hua që ky i fundit kishte marrë nga shtetasi Xh. Sh. Komisioni vlerësoi se deklaratat noteriale të bëra nga shtetasi D. D. dhe Xh. Sh. pas kalimit të barrës së provës mbetën në nivel deklarativ dhe të paprovuara me dokumentacion provues të kohës.

2.69. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, në seancën dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij, vëren se subjekti nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokumentacion ligjor/financiar provues të kohës që të vërtetonte ekzistencën e marrëdhënieve të huadhënies midis z. D. dhe z. Xh. Sh. ndërmjet z. D. dhe shoqërisë “****” sh.p.k.

2.70. Duke u mbështetur në vendimmarrjen e Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se kjo hua është deklaruar nga subjekti si burim vetëm në prapësime, kur i është vënë në dukje nga ana e Komisionit se shtetasi D. D. rezultonte me një bilanc negativ, vlerësohet si deklarim i kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, i pambështetur në prova ligjore në kohën e pretendimit të marrëdhënies së huas, ndaj nuk merret në konsideratë për krijimin e pasurisë së paluajtshme, objekt gjykimi.

2.71. Dokumentacioni i mbledhur e administruar në hetimin administrativ, sikurse edhe ai i sjellë nga subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk arrijnë në nivelin që të

provojnë burimin e ligjshëm në kuadër të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit, për sa i përket ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre.

2.72. Trupi gjykues analizoi provat dhe pretendimet e paraqitura nga subjekti lidhur me të ardhura të tjera të huadhënësit D. D. dhe arsyeton se subjekti nuk ka asnjë dokumentacion ligjor provues lidhur me punësimin apo shërbimin ndërmjet z. D. dhe shoqërisë “****” sh.p.k. dhe, për rrjedhojë, nuk provohet as përfitimi i të ardhurave të tij nga kjo shoqëri.

2.73. Trupi gjykues, në referencë të parashikimeve ligjore dhe në provat që disponon, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të huas, marrë nga shtetasi D. D. , në shumën 6.000.000 lekë dhe ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

2/d/3. Lidhur me kredinë bankare marrë nga “Alpha Bank” sh.a.

i) Për sa i përket përdorimit të kredisë si burim krijimi

2.74. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se kjo kredi u përdor si burim krijimi për këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim vjen në kundërshtim me dokumentacionin ligjor të administruar gjatë hetimit administrativ, nga ku rezultoi e provuar se kredia u disbursua pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së datës 28.2.2005.

2.75. Trupi gjykues vlerësoi sa më sipër edhe në referim të deklarimit të subjektit të rivlerësimit në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 7.1.2015, lidhur me destinacionin e kredisë, ku ai deklaroi se: *“Kam paguar 1.000.000 lekë nga kredia e marrë, pjesën tjetër të kredisë prej 4.000.000 lekësh e ka shfrytëzuar z. D. për rregullimin e bodrumit, të cilin e ktheu në lokal”*.

2.76. Trupi gjykues vlerëson se për sa referuar dokumentacionit të administruar, rezultoi e provuar se kjo kredi u mor me objekt rikonstruksion dhe u deklarua nga subjekti në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 7.1.2015, se u përdor vlera 4.000.000 lekë për investimet e nevojshme për të kthyer bodrumin në lokal dhe për sa rezultoi e provuar se tërheqjet e shumave nga llogaria e kredisë u kryen pas pagimit të vlerës së plotë të pasurisë, pretendimet se kjo kredi ka shërbyer për pagimin e kësaj pasurie janë të pambështetura në dokumentacion ligjor provues dhe në deklaratimet e mëparshme të subjektit.

2.77. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk provon me dokumentacion ligjor provues për blerjen e pjesës së tij takuese në pasurinë e paluajtshme dhe se u përdor si burim kredia e marrë në “Alpha Bank” sh.a.

ii) Për sa i përket shlyerjes së kësaj kredie bankare

2.78. Trupi gjykues arsyeton se për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me shlyerjen e kësaj kredie bankare, subjekti nuk arriti të provojë marrjen paradhënie të shumës 30.800 euro, si pjesë e shumës prej 200.000 euro, për shitjen e pasurisë bodrum me sip. 194 m², me qëllim shlyerjen e kredisë në “Alpha Bank” sh.a.

2.79. Me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 27.5.2008, subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi D. D. i kanë shitur shtetases H. L., e datëlindjes 14.5.1951, pasurinë e llojit “bodrum”, me sip. 194 m², kundrejt çmimit 1.031 euro/m², në total në vlerën 200.014 euro. Në këtë kontratë, palët kanë deklaruar se janë likuiduar totalisht me njëra-tjetrën, jashtë zyrës noteriale, pasi është marrë në dorëzim pasuria, pa pretendime për gjendjen e saj.

2.80. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se: *“Vlera prej 200.000 euro që i korrespondon çmimit të shitjes së kësaj pasurie na është dhënë dorazi jashtë zyrës noteriale nga pala blerëse. Kjo pasuri është marrë në dorëzim nga blerësja ditën e lidhjes së kontratës së shitjes në datën 27.5.2008 dhe në datën 20.6.2008 pala blerëse ka bërë regjistrimin e saj në ZVRPP”*.

2.81. Referuar deklaratimeve të subjektit pasuria është marrë në dorëzim nga blerësja ditën e lidhjes së kontratës së shitjes në datën 27.5.2008. Pagimi i çmimit referuar kontratës së shitjes

është bërë pas marrjes në dorëzim të pasurisë nga pala blerëse dhe pas shlyerjes nga subjekti të pjesës takuese të kredisë në vlerë prej 15.400 euro, me datë 23.5.2008.

2.82. Referuar deklaratimeve të subjektit dhe përcaktimeve ligjore në kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 27.5.2008, trupi gjykues vlerëson se shuma prej 200.000 euro është marrë në datën 27.5.2008, ditën e lidhjes së kontratës së shitjes.

2.83. Trupi gjykues vlerëson se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara nga palët në kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 27.5.2008, dhe se palët kanë pasur të gjitha mundësitë ligjore të parashikonin në hartimin e kontratës së shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme modalitetet e kryerjes së pagesës mes tyre, sipas pretendimeve në përgjigje të barrës së provës.

2.84. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk provon me dokumentacion ligjor provues burimin e përdorur për shlyerjen e pjesës së tij takuese në kredinë e mbetur në “Alpha Bank” sh.a., në shumën 15.400 euro, duke rezultuar me pamundësi financiare lidhur me këtë transaksion financiar në datën 23.5.2008.

2/d/4. Lidhur me mundësinë financiare për blerjen e pjesës takuese në këtë pasuri

2.85. Në përfundim të arsytimit të mësipërm lidhur me burimet dhe analizës financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, lidhur me blerjen e pjesës takuese në këtë pasuri të paluajtshme trupi gjykues arriti në përfundimin se me të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti nuk ka pasur mundësi për blerjen e pjesës takuese në pasurinë bodrum me sip. 194 m², për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzime të tjera, duke rezultuar me bilanc negativ prej -6.906.367 lekësh për harkun kohor 1.1.2005 – 28.2.2005.

2.86. Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti nuk provon ligjshmërinë e burimit të përdorur për shlyerjen e pjesës së tij takuese në kredinë e mbetur në “Alpha Bank”sh.a në shumën 15.400 euro, duke rezultuar me pamundësi financiare lidhur me këtë transaksion financiar në datën 23.5.2008.

2/d/5. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e pjesës takuese të pasurisë

2.87. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme, të cilat, referuar kontratës së shitjes dhe pjesës takuese të subjektit ishin në vlerën 100.000 euro, në kundërshtim me detyrimet e udhëzimit, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së.

2.88. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së llojit “bodrum”, subjekti ka deklaruar gjatë hetimit administrativ se ato janë përdorur për shlyerjen e huas së shtetasit D. D. , shlyerjen e kredisë bankare dhe vlera prej 4.000.000 lekësh u përdor për shpenzime për jetesë për vitet 2008 – 2009, kohë kur vazhdonte periudha e pezullimit, pasi sipas ligjit të kohës gjatë periudhës së pezullimit gjyqtari nuk trajtohej financiarisht.

2.89. Deklarimi i subjektit se vlera prej 4.000.000 lekësh u përdor për shpenzime për jetesë për vitet 2008 – 2009, u arsyetua dhe analizua nga trupi gjykues njëkohësisht me aspektet e tjera të transaksionit, sikurse mungesa e gjurmëve dokumentare të këtij transaksioni apo mungesa e provueshmërisë së fondeve të blerëses, kërkuar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

2.90. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, lidhur me mosdeklarimin në deklaratën *Vetting* të të ardhurave të përfituara nga shitja e kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84.2016 për këto të ardhura.

2.91. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të blerjes së pjesës takuese në pasurinë bodrum me sip. 194 m², në Elbasan, në datën 28.2.2005, duke u

ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

2.92. Subjekti i rivlerësimit lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e pjesës së tij takuese, në këtë pasuri, gjendet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84.2016.

3. Lidhur me konfliktin e interesit me shoqërinë “**” sh.p.k.**

3.1. Dy pasuritë e analizuarra më sipër në këtë vendim janë blerë/ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., shoqëri kjo me ortak të vetëm dhe administrator shtetasin P. K.

3.2. Për sa i përket pasurisë së paluajtshme banesë dy kate + bodrum + nënçati 101 m²/kati, në analizë të dokumentacionit të administruar nga hetimi administrativ dhe shpjegimeve e pretendimeve të subjektit, Komisioni vlerësoi faktet e deklaruara në to, sipas të cilave:

3.3. Shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. rezulton se ka qenë shoqëria ndërtuese e banesës së regjistruar në pronësi të subjektit nga data 17.10.2011.

3.3.1 Palët kishin dakordësuar nisur nga rrethanat e posaçme të njohjes e miqësisë si kosto ndërtimi vlerën 3.300.000 lekë, për sipërfaqen ndërtimore prej 272 m², pavarësisht se për vitin e ndërtimit, referuar kostos mesatare të ndërtimit për qytetin e Elbasanit², ky ndërtim do të kushtonte 5.237.904 lekë.

3.4. Shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. rezulton gjithashtu se i ka shitur subjektit dhe bashkëpronarit të tij pasurinë bodrum me sip. 194 m² dhe gjatë hetimit u deklarua prej subjektit se kishte marrëdhënie miqësie/mirëbesimi si pasojë e lidhjes familjare me z. P. K.

3.5. Komisioni e ka pyetur subjektin në pyetësorin nr. 3 nëse ka pasur në gjykim çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k. apo shtetasin P. K.

3.6. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, deklaroi: *“Nuk kam pasur në gjykim çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k. as me shtetasin P. K.”*.

3.7. Komisioni i kërkoi informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila konfirmoi se subjekti ka gjykuar çështjen me objekt “Lëshim urdhër ekzekutimi”, me datë 15.7.2021, me kërkues U. K. E. sh.a., me palë debitore P. K.

3.8. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime në lidhje me sa duket se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 5, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, kur ka gjykuar çështjen me objekt “Lëshim urdhër ekzekutimi”, me datë 15.7.2021, me kërkues U. K. E. sh.a., me palë debitore P. K.

3/a. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

3.9. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, deklaroi se: *“Komisioni referon si bazë për pretendimin e ngritur, pika 6 e nenit 72, e cila përcakton se: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”. Ky parashikim i nenit 72 të Kodit duhet të interpretohet në mënyrë harmonike me parashikimet e nenit 73 të Kodit, i cili përcakton se: “Gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij”. Sikurse konstatohet, legjislatori e ka lënë në çmimin e brendshëm të gjyqtarit ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes dhe jo heqjen dorë detyrimisht. Aq më shumë heqja dorë sipas pikës 6 të nenit 72 është e gjitha e kushtëzuar nga bindja e brendshme e gjyqtarit. Në situatën konkrete, objekt shqyrtimi, rezulton se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit ka qenë në kah të kundërt me atë që mund të konsiderohej interesi i tij. Pretendimi*

² Referuar Udhëzimit nr. 3, datë 16.10.2002 dhe Udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave.

i Komisionit për zbatimin e ligjit nr. 9367/2005 në raport me Kodin e Procedurës Civile është tërësisht i pabazuar dhe i pazbatueshëm”.

3/b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave dhe fakteve me ligjin e zbatueshëm

3.10. Komisioni, duke pasur parasysh shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit e përfaqësuesit ligjor në seancën dëgjimore – arsyeton se:

3.11. Referuar ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, marrja e favoreve ose trajtimeve preferenciale renditen si raste të kufizimeve të interesave privatë të zyrtarit për parandalimin e konfliktit interesit.

3.12. Nga rrethanat e çështjes është fakt se subjekti kishte pasur marrëdhënie me interesa preferencialë ekonomikë, konfirmuar në hetimin administrativ, si dhe marrëdhënie miqësie/mirëbesimi, deklaruar nga subjekti si pasojë e lidhjes familjare me z. P. K.

3.13. Në kuptim të nenit 5, pika 1, shkronjat “dh”/“v” të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, dhe nenit 72, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga vendimmarrja në çështjen me palë z. P. K., për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

3.14. Në vlerësim të situatës faktike, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, në këtë vendimmarrje.

3.15. Lloji i vendimmarrjes nuk përjashton subjektin e rivlerësimit nga detyrimi ligjor që ka pasur për heqjen dorë prej shqyrtimit të kësaj çështjeje.

4. Automjeti tip “**”**

4.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: *“Automjeti blerë sipas kontratës së shitblerjes datë 10.5.2012, përkundrejt shumës 1.000 euro. Burimi i krijimit: kursimet e ardhurave familjare. Pjesa takuese: 100%”.*

4.2. Në DIPPV-në e vitit 2012 subjekti nuk ka deklaruar blerje pasurie të luajtshme, automjet, ndërsa në DIPPV-në e vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Autoveturë e markës “****”, tip ***, vit prodhimi 2002, në shumën 1.000 euro, duke deklaruar kontratën e shitblerjes së datës 10.5.2012 dhe zhdoganimin dhe regjistrimin në shtator të vitit 2013”.*

4.3. Në bazë të të dhënave të administruara nga hetimi rezulton i regjistruar në emër të subjektit automjeti me targa ***.

4.4. Subjekti i rivlerësimit, në pyetësin nr. 3, pyetur në lidhje me faktin që zhdoganimi dhe regjistrimi i këtij automjeti është bërë gati 1 vit e 3 muaj nga data e blerjes dhe pas përdorimit e tij për periudhën maj 2012 – shtator 2013, deklaroi se: *“Për shkak të kohës së gjatë nuk mund të kujtoj me saktësi periudhën e saktë të përdorimit të këtij mjeti dhe veprimet e kryera me të, por, mesa kujtoj, deri në momentin e zhdoganimit të mjetit dhe regjistrimit të tij pranë DRSHTRR-së nuk e kam përdorur këtë mjet, pasi rezultoi me probleme që lidheshin me gjendjen teknike të mjetit”.*

4.5. Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se automjeti tip “****” ka hyrë rishtas në pikën kufitare Qafë-Thanë në datën 12.9.2013, pas hyrjes në datën 6.7.2011, në Durrës, ndërkohë që zhdoganimi i tij është bërë në datën 13.9.2013, subjektit i është kërkuar të shpjegojë qëllimin, kohën dhe mënyrën e nxjerrjes dhe zhdoganimit gati 1 vit e 3 muaj nga data e blerjes së automjetit në pronësi të tij prej datës 10.5.2012, referuar kontratës së shitblerjes.

4.6. Në përgjigje, subjekti ka sqaruar: *“Pasi mjetit të tipit “****”, prodhim i vitit 2002, i bëra disa shërbime në mënyrë që të ishte në gjendje të rregullt teknike, u interesova për t’i bërë*

procedurat e zhdoganimit. Nga ana e agjencisë doganore m'u bë me dije se ka kaluar një periudhë e gjatë kohore që kur mjeti ka hyrë në territorin shqiptar dhe nuk dihet se çfarë është bërë me këtë mjet në shtetin italian, nëse janë kryer procedurat e çregjistrimit në shtetin italian dhe nëse makina ka apo jo probleme në lidhje me dokumentacionin në shtet të huaj.

Për këtë arsye, mënyra më e mirë për t'u siguruar që mjeti nuk kishte probleme më duhej ta kaloja në një pikë doganore. Duke qenë se pika më e afërt doganore ishte pika e kalimit kufitar Qafë-Thanë, vendosa të shkoj atje për t'u siguruar. U paraqita në një nga agjencitë në doganën e Qafë-Thanës dhe, mesa me kujtohet, spedinsioneri i asaj agjencie bëri kalimin e mjetit dhe verifikimet për të cilat unë isha i interesuar, nëse mjeti kishte problem apo ndonjë denoncim të mundshëm në shtetin italian. Këtë veprim e kam ndërmarrë pasi në atë periudhë mjaft automjete që hynin në territorin e Shqipërisë më pas rezultojnë me probleme dokumentacioni apo edhe të vjedhura, duke u bërë fenomen shqetësues për kohën...”.

4/a. Analiza e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

4.7. Në deklaratën Vetting subjekti, si burim të ardhurash për blerjen e kësaj pasurie të luajshme automat, ka deklaruar kursimet nga të ardhurat familjare.

4.8. Nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja e tij, nuk kanë deklaruar kursime *cash* në banesë për periudhën deri në fund të vitit 2011, Komisioni kreu analizën financiare për harkun kohor 1.1.2012 – 10.5.2012, për të evidentuar mundësinë financiare të blerjes së automjetit tip “***”, duke përfshirë edhe pasuri të tjera të krijuara (edhe depozitën me afat në emër të bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”, të krijuar në datën 20.2.2012) dhe shpenzime të ndryshme të deklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë.

Analiza e treguesve financiarë për harkun kohor 1.1.2012 – 10.5.2012	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga puna e subjektit, dokumentuar për periudhën	435.972
Të ardhurat neto nga puna e bashkëshortes, dokumentuar për periudhën	161.916
Të ardhurat e nënës nga pensioni	45.916
Total të ardhura/të hyra financiare	643.804
Shpenzime kredie tek Fondi Besa, paguar në datën 26.3.2012	80.000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për periudhën (5 persona)	248.510
Total shpenzime/të dala financiare	328.510
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim-gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-596.890
Mjete monetare të disponueshme (1)	-281.596
Blerje automjeti tip “***” në shumën 1.000 euro	139.590
Total pasuri	139.590
Detyrime financiare	0
Pasuri neto (2)	139.590
Balanca e fondeve (1-2)	-421.186

4.9. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur prova e shpjegime në lidhje me sa duket se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me burime të ligjshme blerjen e automjetit tip “***” në datën 10.5.2012, në shumën 1.000 euro, krijimin e depozitës në “Raiffeisen Bank” në emër të bashkëshortes në datën 20.2.2012 dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara, deklaruara dhe llogaritura për harkun kohor 1.1.2012 – 10.5.2012, duke rezultuar me pamundësi financiare në vlerën -421.186 lekë.

- Hyrja rishtas e këtij automjeti në pronësi të subjektit në territorin shqiptar në datën 12.9.2013, pa u dokumentuar dalja e tij dhe kryerja e zhdoganimit, 1 vit e 3 muaj nga data e blerjes së automjetit në pronësi të subjektit prej datës 10.5.2012, përbëjnë zgjedhje të cilat jo vetëm nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por e dëmtojnë atë.

4/b. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

4.10. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi: *“Kontrata e shitblerjes së automjetit është bërë në datën 10.5.2012. Nisur nga fakti që kontrata e shitblerjes së mjetit është nënshkruar pas datës 31.3.2012, për shkak të gjendjes teknike të mjetit (gjendje e cila përkon edhe me vlerën e ulët të blerjes së tij) nuk ka qenë e mundur që ky i fundit të përdorej gjatë periudhës 2012 – 2013. Vetëm me rregullimin e mjetit është bërë e mundur që ky i fundit të përgatitej për përdorim, moment në të cilin janë kryer edhe veprimet e para për përfundimin e procedurave doganore dhe të regjistrimit të mjetit. Ndryshe nga sa arsyeton Komisioni, dalja dhe rihyrja e mjetit në territorin e Republikës së Shqipërisë është bërë konform ligjeve të shtetit për hyrjen dhe daljen. Mosregjistrimi i daljes së mjetit nga ana e Policisë së Shtetit nuk është përgjegjësi e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë ky i fundit në përgjigjet e dhëna ka detajuar veprimet e tij në drejtim të kalimit të pikës kufitare.*

4.11. *Pretendimi i Komisionit se veprimet e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e veprimeve juridike të caktuara janë krejtësisht të pambështetura. Në lidhje me analizën e treguesve financiarë, metodologjia e përdorur për të arritur në konkluzionin e paaftësive apo burimeve të pamjaftueshme është pasojë e metodologjisë së gabuar si rrjedhojë, nuk pasqyron realitetin”.*

4/c. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.12. Komisioni, duke pasur parasysh provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 - 50 të ligjit nr. 84/2016, shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit e përfaqësuesit ligjor në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

4.13. Trupi gjykues vlerësoi shpjegimet e subjektit se pasi kaloi një periudhë e gjatë kohore që kur mjeti ka hyrë në territorin shqiptar dhe nuk dihet se çfarë është bërë me këtë mjet në shtetin italian, nëse janë kryer procedurat e regjistrimit në shtetin italian dhe nëse automjeti ka apo jo probleme në lidhje me dokumentacionin në shtet të huaj iu mundësua ta kalonte atë në një pikë doganore, duke rifutur rishtas këtë automjet, prej 1 viti e 3 muaj në pronësi të tij.

4.14. Subjekti nuk arriti të shpjegojë si arriti të realizojë daljen e mjetit në pronësi të tij nga territori shqiptar dhe hyrjen e këtij automjeti në pronësi të tij sikur ai po futej për herë të parë në datën 12.9.2013 në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas kalimit të 1 viti e 3 muaj nga blerja e tij.

4.15. Kjo procedurë e zgjedhur dhe shpjeguar nga subjekti si mënyra më e mirë për t’u siguruar që mjeti i blerë prej tij nuk kishte probleme, ishte në shkelje të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

4.16. Në lidhje me pretendimet e subjektit që për efekt të analizës financiare mbi mundësinë e blerjes së automjetit tip “***”, në datën 10.5.2012, në shumën 1.000 euro, krijimin e depozitës në “Raiffeisen Bank” në emër të bashkëshortes në datën 20.2.2012, si dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara, deklaruara dhe llogaritura për harkun kohor 1.1.2012 – 10.5.2012, duhet të merren në konsideratë të dhënat financiare të subjektit për periudhën paraardhëse, Komisioni vlerëson se ky pretendim bie në kundërshtim me mënyrën dhe formën e deklaratimit të përcaktuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

4.17. Referuar deklaratimit për herë të parë dhe deklarimeve të interesave periodikë/privatë vjetorë të depozituar nga subjekti pranë ILDKPKI-së dhe të administruar nga Komisioni,

subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesat dhe pakësimet, kursime gjendje *cash* në banesë për periudhën 2003 – 2011, pra rezulton se subjekti nuk ka të akumuluar kursime *cash* deri në fund të vitit 2011, të cilat mund të përdoren për krijim të pasurive dhe mbulim të shpenzimeve në vitin 2012.

4.18. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e barrës e provës, duke mos provuar mundësinë financiare për blerjen e automjetit tip “****”, krijimin e depozitës në “Raiffeisen Bank” në emër të bashkëshortes në datën 20.2.2012 dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara dhe llogaritura, duke rezultuar me bilanc negativ prej -421.186 lekësh për harkun kohor 1.1.2012 – 10.5.2012.

4.18.1 Veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri të luajtshme përbëjnë zgjedhje, të cilat nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut të drejtësia, në kuptim të parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

5. Analiza e treguesve financiarë për periudhën 2003 – 2016

5.1. Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 2003 – 2016, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, deklarimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur nga e cila ka rezultuar se për vitet e mbyllura 2005, 2006, 2007, 2008, 2012 dhe 2016 subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të dokumentuara për blerje/krijim të pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara për këto vite.

5.2. Analiza financiare është kryer për të verifikuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga këto burime, duke marrë në konsideratë vlerën e pasurive dhe likuiditeteteve në bankë dhe në gjendjen *cash* të deklaruar.

5.3. Në përfundim të analizës financiare të kryer ka rezultuar se për periudhën e deklarimit subjekti dhe personi i lidhur kanë qenë në pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, duke rezultuar me balanca negative, përkatësisht për vitin 2005 në vlerën -7.665.454 lekë, për vitin 2006 në vlerën -1.173.231 lekë, për vitin 2007 në vlerën -1.173.297 lekë, për vitin 2008 në vlerën 622.993 lekë, për vitin 2012 në vlerën -263.588 lekë dhe për vitin 2016 në vlerën 182.892 lekë.

5.4. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit lidhur me pamundësinë financiare të tij për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitet përkatëse.

5/a. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

5.5. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, shpjegoi: *“Në gjykimin e subjektit të rivlerësimit, sikurse cituar edhe në pjesën hyrëse të këtyre shpjegimeve, metodologjia e përdorur është e gabuar, çka ka sjellë edhe rezultate të gabuara të hetimit administrative.*

Në analizën e treguesve financiarë shuma prej 1.879.200 lekësh e tërhequr nga “Alpha Bank” në datën 5.10.2004 është klasifikuar si shpenzim pa destinacion, duke ndikuar në këtë formë në rezultatin e viteve 2003 dhe 2004.

Shuma prej 7.000.000 lekësh e paguar për blerjen e bodrumit me sip. 194 m² është pasqyruar si shpenzim, por pa marrë parasysh kontratën e huamarrjes së datës 3.3.2005.

Njëkohësisht, kontrata e kredisë bankare në vlerën 5 milionë lekë është regjistruar edhe si e ardhur në vlerën 2.500.000 lekë, edhe si shpenzim në të njëjtën vlerë, ndërkohë që nga subjekti i rivlerësimit është deklaruar se nga ana e tij është përdorur vetëm 1.000.000 lekë për pagesën e detyrimit të mbetur të pjesës takuese prej 7.000.000 lekësh, ndërsa pjesa tjetër është përdorur nga shtetasi D. D. .

Subjekti i rivlerësimit në asnjë rast nuk ka deklaruar se nga ana e tij janë përdorur apo shpenzuar të ardhura për rregullimin e bodrumit dhe, për pasojë, edhe sikur t'i marrim për të mirëqena këto shpenzime, ato nuk mund t'i ngarkohen subjektit të rivlerësimit.

Të ardhurat në masën 100.000 lekë/muaj, të përfituara nga dhënia me qira e pjesës takuese të pasurisë bodrum me sip. 194 m², gjithashtu nuk janë pasqyruar në analizën e treguesve financiarë, me argumentimin se për këto të ardhura nuk provohet as përfitimi i tyre dhe as pagimi i detyrimeve përkatëse tatimore.

Në këtë rast Komisioni aplikon standarde të dyfishta dhe të ndryshme për sa i përket shpenzimeve dhe të ardhurave. Në rastin e shpenzimeve shtesë në vlerën 200.000 lekë të deklaruar nga subjekti për shtëpinë në vitin 2004, Komisioni i merr të mirëqena, ndërsa deklarimin e të ardhurave e kushtëzon me faktin e pagesës së detyrimeve tatimore.

Referuar legjislacionit tatimor lejohet pagesa në cash për vlera më të vogla se 130.000 lekë, çka nënkupton që qiramarrësi është mjaftuar me pagesën e vleftës së qirasë pa qenë nevoja që një pagesë të tillë ta realizonte nëpërmjet llogarisë bankare”.

5/b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

5.6. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49-50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e subjektit dhe përfaqësuesit të tij ligjor në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

5.7. Analiza e treguesve financiarë është kryer nga Komisioni për të verifikuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga këto burime, mbështetur në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, legjislacionin përkatës, si dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

5.8. Në lidhje me analizën financiare (emërtuar “lëvizja dhe ndryshimi i cash në vite”), të depozituar nga vetë subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni konstaton se si metodologjia e ndjekur në hartimin e kësaj analize, të dhënat e pasqyruara, ashtu edhe konkluzionet e pretenduara, nuk mbështeten në dokumentacion ligjor/financiar, si dhe në deklaratimet e subjektit dhe personave të lidhur gjatë hetimit administrativ.

5.9. Konkretisht, në këtë analizë ka mospërputhje të pasqyrimin të kohës së blerjes, krijimit të pasurisë së llojit “bodrum”, e cila referuar dokumentacionin ligjor është blerë në vitin 2005, ndërsa në analizën e depozituar nga subjekti është pasqyruar në vitin 2004, gjithashtu në këtë vit janë pasqyruar edhe ngjarje të tjera ekonomike të dokumentuara të ndodhura në vitin 2005.

5.10. Në lidhje me pretendimet për të ardhurat për rregullimin e bodrumit, trupi gjykues ka vlerësuar se në analizën financiare të kryer, në të ardhura/hyrje likuiditete, është pasqyruar edhe kredia e marrë nga subjekti në bashkëkredimarrje, duke pasqyruar vetëm pjesën e tij takuese (½). Gjithashtu, në shpenzim për vitin 2005 është vlerësuar të pasqyrohet shuma prej 2.500.000 lekësh (pjesë takuese e subjektit nga kredia e përbashkët e marrë me shtetasin D. D. në “Alpha Bank” sh.a., me kontratë datë 21.4.2005, në shumën 5.000.000 lekë), si dhe shlyerjet e kredisë, vetëm 50% e vlerës së kësteve dhe komisioneve/sigurimeve të paguara.

5.11. Trupi gjykues vlerëson se pas rezultateve të hetimit subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor/financiar pretendimet në lidhje me moskontributin e tij në rregullimin e bodrumit, si dhe lidhur me shumën e përfiturar prej tij nga kjo kredi, referuar legjislacionit bankar bashkëkredimarrësit janë të dy përfitues.

5.12. Për sa i përket pretendimeve të subjektit për mospërdorim nga ana e tij të shumës së kredisë dhe për përfshirje të shumës së marrë hua në vitin 2005 në analizë, përveç sa u trajtua më sipër, trupi gjykues ka vlerësuar se huaja në shumën 6.000.000 lekë, që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të marrë nga shtetasi D. D. me kontratën datë 3.3.2005, të mos përfshihet në analizën financiare si burim për blerjen e pjesës takuese në pasurinë e llojit “bodrum” me sip. 194 m², në lagjen “****”, Elbasan, si dhe në analizën financiare për vitin e mbyllur 2005, sipas arsytimit më lart të Komisionit lidhur me këtë hua.

5.13. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që të përfshihen në analizë edhe të ardhurat në masën 100.000 lekë/muaj, përfituar nga dhënia me qira e pjesës takuese të bodrumit me sip. 194 m².

5.14. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arsyeton se subjekti, përveç deklarimit të këtyre të ardhurave në DIPPV-në e vitit 2007, nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për kohën e përfitimit të këtyre të ardhurave dhe pagesën e detyrimeve përkatëse tatimore, në zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në të cilin përcaktohet se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...”*.

5.15. Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të provojnë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit me barrën e provës në rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me balancat negative, përkatësisht për vitin 2005 në vlerën -7.665.454 lekë, për vitin 2006 në vlerën -1.173.231 lekë, për vitin 2007 në vlerën -1.173.297 lekë, për vitin 2008 në vlerën 622.993 lekë, për vitin 2012 në vlerën -263.588 lekë dhe për vitin 2016 në vlerën 182.892 lekë, duke rezultuar me një balancë negative për vitet e deklarimit në vlerën e përgjithshme prej -11.081.455 lekësh.

5.16. Mungesa e burimeve të ligjshme financiare në vlerën e përgjithshme prej -11.081.455 lekësh, në krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën e deklarimit, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61 dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Gjetje të tjera nga hetimi administrativ

6. Përdorimi i automjetit tip “**”**

6.1. Në bazë të të dhënave nga sistemi TIMS rezulton se subjekti ka përdorur në udhëtimet e tyre automjetin tip “****”, ngjyrë e zezë, vit prodhimi 2008, me targa ***, automjet i cili në periudhën e përdorimit ka qenë në pronësi të shtetasit R. B.

6.2. Rezulton se në datën 27.10.2020 është regjistruar leja e qarkullimit rrugor në emër të z. Taulant Tafa, për automjetin tip “****”, me targa ***, vit prodhimi 2008.

6.3. Me kontratë shitjeje pasurie të luajtshme (automjet) datë 26.10.2020, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi R. H. B. automjetin tip “****”, me targa ***, kundrejt shumës 420.000 lekë, likuiduar në “Raiffeisen Bank” në datën 26.10.2020.

6.4. Bashkëlidhur dosjes: (i) certifikata e pronësisë së automjetit me targa ***, në emër të shtetasit R. B., datë 4.10.2016; (ii) kontrata e shitblerjes së automjetit datë 3.10.2016, nëpërmjet së cilës “****” i shet shtetasit R. B. automjetin kundrejt shumës 1.320.000 lekë (likuiduar plotësisht); (iii) deklarata doganore datë 25.7.2016, ku vlera e automjetit të deklaruar ishte 7.500 euro dhe vlera e detyrimeve doganore ishte 211.487 lekë; (iv) fatura tatimore e shitjes nr. ***, datë 3.10.2016.

6.5. Në pyetësin standard subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e automjetit me targa ***. Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, subjekti i është kërkuar deklarimi i rasteve të përdorimit të këtij automjeti, marrëdhënia me pronarin dhe shkakun e mosdeklarimit të përdorimit të këtij automjeti në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësin standard.

6.6. Subjekti deklaroi se këtë automjet e ka përdorur në udhëtimet: (i) në datën 13.11.2016, nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Murriqan, ku ka udhëtuar në drejtim të Malit të Zi; (ii) në datën 14.9.2018, nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Tushemisht, udhëtuar në drejtim të Maqedonisë dhe kthyer në datën 15.9.2018; (iii) në datën 24.12.2018, nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Murriqan, ku ka udhëtuar në drejtim të Malit të Zi dhe kthyer në datën 27.12.2018; (iv) në datën 27.8.2019, nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Murriqan, ku ka udhëtuar në drejtim të Malit të Zi dhe kthyer në datën 1.9.2019.

6.7. Në lidhje me mosdeklarimin në pyetësin standard të përdorimit të këtij automjeti, subjekti ka shpjeguar: *“Në këtë pyetësor kam deklaruar faktin që kam përdorur automjete të personave të tjerë në periudha të ndryshme kohore, por nuk kam specifikuar detajet, pasi nuk kam menduar që duheshin përcaktuar në atë fazë”.*

6.8. Nisur nga fakti që për periudhën nëntor 2016 e në vazhdim, subjekti i rivlerësimit e ka përdorur këtë automjet (fillimisht në pronësi të shtetasit R. B. nga data 3.10.2016, e më pas në pronësi të tij, pas datës 26.10.2020) dhe i është kërkuar të deklarojë nëse z. B. e ka përdorur këtë mjet për periudhën tetor 2016 – tetor 2020, si dhe burimin e të ardhurave të këtij shtetasi për pagesën e shumës prej 1.320.000 lekësh në datën 3.10.2016.

6.9. Rezulton se pasi automjeti është blerë nga shtetasi R. B. në datën 3.10.2016 dhe në datën 13.11.2016 është përdorur nga subjekti për udhëtimin në drejtim të Malit të Zi nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Murriqan dhe nga koha e blerjes së këtij automjeti duket se provohet vetëm përdorimi i tij nga ana e subjektit dhe mbeti i paprovuar përdorimi nga ana e pronarit faktik të tij deri në vitin 2020, kohë kur mjeti u ble nga subjekti i rivlerësimit.

6.10. Shtetasi R. B., referuar policës së sigurimit të datës 14.9.2016, paraqitet si përdorues i automjetit tip “****”, me targa ***, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, duke ngritur dyshime mbi arsyet e përdorimit të automjeteve reciproke nga subjekti dhe ky shtetas, referuar edhe ndryshimit në vlerën respektive të tyre, me 10-fishin e vlerës.

6.11. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuar të provojë arsyet e shkëmbimit të përdorimeve të automjeteve me shtetasin R. B., për të provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm që nuk ndodhet në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, nisur nga sa:

- i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si në deklaratën *Vetting* ashtu edhe në pyetësin standard përdorimin nga ana e tij të automjetit tip “****”, me targa ***;
- ii) nuk provohet përdorimi i këtij automjeti nga shtetasi R. B.;
- iii) referuar policës së sigurimit të datës 14.9.2016 shtetasi R. B. është përdorues i automjetit tip “****”, me targa ***, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

6/a. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

6.12. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, sqaroi se *pretendimi për mosdeklarimin në pyetësin standard të përdorimit të mjetit me targa ***, në pyetësin nr. 3 ka sqaruar se nga ana e tij është deklaruar përdorimi i mjeteve në pronësi të të tretëve, por pa dhënë specifikime në lidhje me llojin, targën apo pronësinë e mjetit, për shkak se në momentin e plotësimit të pyetësit nuk ishte e qartë nëse ky informacion kërkohej në formë të detajuar. Në përgjigjet e pyetësit nr. 3 janë deklaruar data dhe modalitetet e përdorimit të automjetit tip “****” në pronësi të shtetasit R. B. Sikurse rezulton nga të dhënat e sistemit TIMS, ky mjet është përdorur nga subjekti në 4 raste, të cilat janë të shtrira në periudhën kohore 2016 – 2020. Pretendimi i ngritur nga Komisioni se nuk provohet përdorimi i këtij mjeti nga shtetasi R. B. nuk jep së paku një indicie se me çfarë prove është e mundur që subjekti i rivlerësimit të provojë përdorimin e një mjeti nga pronari i tij i ligjshëm. Pronësia mbi mjetin përbën fakt të pakundërshtueshëm dhe krijon edhe prezumimin se pronari i mjetit është edhe përdoruesi i tij, të paktën për sa kohë nuk ka një provë që provon të kundërtën e këtij prezumimi. Fakti i përdorimit të mjetit nga subjekti i rivlerësimit në 4 raste specifike dhe me data të*

kufizuara në një periudhë kohore prej 4 vitesh nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e prezumimit se mjeti përdoret nga pronari i tij i ligjshëm.

Është fakt i provuar që polica e sigurimit e datës 14.9.2016, e automjetit në pronësi të subjektit të rivlerësimit, rezultoi të jetë lëshuar në favor të shtetasit R. B., por ky fakt është rrjedhojë e marrëdhënieve shumë të ngushta që subjekti i rivlerësimit në vijimësi ka deklaruar që ka me këtë shtetas. Duke marrë në konsideratë faktin që shtetasi R. B. nuk është subjekt i proceseve gjyqësore civile apo penale të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit, nuk është person i cili paraqet kritere cenuese si kontakt i papërshtatshëm në marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, si dhe përveç marrëdhënies shoqërore nuk rezultoi të ketë asnjë marrëdhënie tjetër me subjektin e rivlerësimit, provon se kjo marrëdhënie ndërmjet subjektit dhe shtetasit R. B. është një marrëdhënie e bazuar në interesa financiare apo të ndryshëm nga ata shoqërorë.

6/b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

6.13. Komisioni, duke pasur parasysh provat shkresore të administruara, sipas neneve 49 - 50 të ligjit nr. 84/2016 dhe shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramet në seancën dëgjimore, arsyeton si vijon:

6.14. Përdorimi i këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit duhet të deklarohet në deklaratën *Vetting*, në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën jepet përkufizimi i fjalës “pasuri”, ku parashikohet se: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”*.

6.15. Trupi gjykues vëren se lidhur me përdorimin e këtij automjeti, shpjegimet e subjektit nuk paraqesin prova kundërshtuese, si dhe nuk i përgjigjen faktit se përdorimi i tij nuk ishte deklaruar asnjëherë. Shpjegimet e subjektit fokusohen vetëm se pronësia mbi mjetin përbën fakt të pakundërshtueshëm dhe krijon edhe prezumimin se pronari i mjetit është edhe përdoruesi i tij.

6.16. Shpjegimet e dhëna nga subjekti vlerësohen se nuk janë bindëse, dhe nuk provojnë të kundërtën e barrës së provës pasi jo vetëm nuk rezultoi i provuar me ndonjë akt në dosje përdorimi prej pronarit të tij i këtij automjeti, por subjekti nuk dha asnjë arsye bindëse se përse ky shtetas, ndërkohë që i linte në përdorim automjetin e tij subjektit të rivlerësimit, merrte në përdorim automjetin në pronësi të subjektit, me kosto disa herë më të lirë.

6.17. Trupi gjykues, pasi analizoi rrethanat, rezultuar nga hetimi të tilla si: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në pyetëtorin standard përdorimin nga ana e tij të automjetit tip “****”, me targa ***; (ii) shkëmbimi i përdorimeve të automjeteve me shtetasin R. B. dhe shpjegimet e subjektit në përgjigje të barrës së provës – arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri ndodhet në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

7. Përdorimi i automjetit të shoqërisë “**” sh.p.k.**

7.1. Gjatë hetimit administrativ, nga të dhënat e sistemit TIMS ka rezultuar se subjekti në datën 17.4.2016 ka udhëtuar me automjetin në pronësi të shoqërisë “****”.

7.2. Subjekti u pyet për lidhjen/marrëdhënien me pronarin e automjetit (përfshirë edhe administratorin/ortakun e shoqërisë tregtare) dhe nëse si gjyqtar ka shqyrtuar çështje me palë ndërgjyqëse individët/shoqëritë në pronësi të të cilëve ka qenë ky automjet.

7.3. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, sqaroi: *“Me të gjithë pronarët e ligjshëm të mjeteve të mësipërme kam lidhje shoqërore”*. Më tej, subjekti sqaroi se ka zhvilluar vetëm një gjykim me shoqërinë “****”, me objekt “Lëshim urdhri ekzekutimi”, me kërkues shoqërinë “****” sh.p.k. kundër debitorit “****”.

7.4. Komisioni administroi shkresën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga e cila rezulton se subjekti, krahas çështjes civile me palë shoqërinë “****” dhe shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt “Lëshim urdhri ekzekutimi”, ka qenë vendimmarrës edhe në vendimin nr. ***, datë 7.4.2011, me paditës shoqërinë “****” dhe palë të paditur Bashkinë Elbasan, me objekt “Përmbushja e detyrimit kontraktor”, ku në përfundim të gjykimit ka vendosur në favor të palës paditëse, shoqërisë “****”, duke pranuar pjesërisht padinë dhe detyruar palën e paditur, Bashkinë Elbasan, të shpërblejë palën paditëse në vlerën 80.030.574 lekë.

7.5. Ndodhur para këtyre fakteve, Komisioni pyeti sërish subjektin nëpërmjet pyetësorit nr. 4 në lidhje me: (i) mospërputhjet e deklaramit të subjektit në pyetësorin nr. 3 me të dhënat e përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan; si dhe (ii) në kushtet kur ka qenë vendimmarrës në çështje civile, ku palë ndërgjyqëse është një shoqëri me të cilën ka pasur apo vazhdon të ketë marrëdhënie, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005 (të ndryshuar) dhe a ka vlerësuar se ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në vendimmarrjet përkatëse.

7.6. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, sqaron: *“Në lidhje me pyetjen e parë dua të sqaroj se përgjigjja ime në pyetësorin e kaluar lidhur me numrin e çështjeve të gjykuara, për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. është bërë duke u bazuar në një shkresë kthim përgjigjeje, lëshuar nga zyra e arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe e konfirmuar nga zv/kryetarja e gjykatës me shkresën e datës 20.6.2022.*

*Nga ana juaj citohet se nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ju është vënë në dispozicion një shkresë, sipas së cilës me shoqërinë “****” sh.p.k. kam gjykuar edhe një çështje tjetër në vitin 2011, vendim të cilin nuk e kujtoj për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe numrit të madh të çështjeve të gjykuara çdo vit, mesatarisht 900 vendime gjyqësore dhe mijëra seanca gjyqësore në vit. Për shkak të pamundësisë objektive për t’i kujtuar vendimmarrjet e mia me kujtesë të lirë, i jam drejtuar me shkresë gjykatës për të marrë informacion të saktë dhe zyrtar. Unë kam besuar se informacioni ishte i saktë, për sa kohë titullari i institucionit ka akses në sistem për të verifikuar numrin e çështjeve të gjykuara. Pra, unë kam rënë në lajthim në fakt, për shkak se përmbajtja e informacionit të shkresës nuk ka qenë e saktë, e jo për shkak të ndonjë veprimi apo mosveprimi të kryer nga ana ime.*

*Në lidhje me pyetjen e dytë për konfliktin e interesit, dua të theksoj se në mënyrë absolute nuk kam qenë në kushtet e konfliktit të interesit kur kam dhënë vendimin nr. ***, datë 7.4.2011, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. Siç është e dukshme, vendimi nr. *** është dhënë në datën 7.4.2011, pra në vitin 2011, kohë kur midis meje dhe pronarit të kësaj shoqërie nuk ka pasur kurrsesi asnjë lloj raporti shoqërie, miqësie, armiqësie, e asnjë lloj raporti të asnjë lloj natyre. Marrëdhënia jonë, me sa mbaj mend, ka lindur rreth vitit 2015 në rrethana krejt rastësore. Kemi rastisur në një ambient me miq të përbashkët e aty ka filluar njohja dhe shoqëria jonë, e cila vijon edhe sot. Ligji për konfliktin e interesit shmang një konflikt aktual ose të ardhshëm, por nuk mund të ketë efekt prapaveprues për një situatë të kaluar, nëse në kohën e ndodhjes së saj nuk ka ekzistuar rrethana bazë “shkaku i konfliktit të interesit”. Me shtetasin F. K. kam filluar shoqërinë në vitin 2015, si rrjedhim në këtë periudhë ka lindur edhe shkaku i konfliktit midis nesh, pra që nga viti 2015 unë nuk duhet të gjykoja çështje me këtë palë”.*

7.7. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumente në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni se në kushtet kur: (i) subjekti ka zhvilluar një gjykim me shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt “Lëshim urdhri ekzekutimi” me kërkues shoqëria “****” sh.p.k., kundër debitorit “****”; (ii) ka konfirmuar marrëdhënien e miqësisë me administratorin e shoqërisë “****”; (iii) ka udhëtuar me automjetin me targa ***, në pronësi të shoqërisë “****” përpara zhvillimit të gjykimit në datën 17.12.2021, duket se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 5, pika 1, shkronjat “dh”/“v” të ligjit nr. 9367/2005 dhe në bazë të nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga çështja për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

7/a. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

7.8. Subjekti i rivlerësimit, në seancë dëgjimore, sqaroi: *“Me sa mbaj mend, për shkak të një gëzimi familjar menduam që të shkonim për një drekë në shtetin maqedonas, më saktë në Manastir, shumë pranë kufirit dhe duke qenë se automjeti im rezultonte me defekt i kërkova vetëm për të shkuar edhe për të drekuar me familjen dhe mesa mbaj mend në të njëjtën ditë që kam shkuar edhe jam kthyer nga Maqedonia, Manastiri, që është shumë pranë kufirit shtetëror me Republikën e Maqedonisë së Veriut, me kohë as një orë. Po ky është i vetmi moment që unë kam përdorur automjetin e “***”. Mesa mbaj mend, duke qenë se “***” është një shoqëri që ka pasur shumë, disa automjete në përdorim. Mesa mbaj mend, një nga punonjësit si drejtues mjetesh, pra si shofer që flitet, i themi ne në gjuhën tonë, mbaj mend që ai ma ka sjellë edhe më ka dhënë makinën. Nuk më kujtohet ky moment, ndoshta mund të kem komunikuar në rrugë tjera, thjesht nuk më kujtohet ky moment”.*

7/b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.9. Komisioni, duke pasur parasysh: provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 - 50 të ligjit nr. 84/2016; shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit e përfaqësuesit ligjor në seancë dëgjimore arsyeton se:

7.10. Në kushtet kur subjekti ka zhvilluar gjykim me shoqërinë “***” sh.p.k. me objekt “Lëshim urdhri ekzekutimi”, me kërkues shoqëria “***” sh.p.k. dhe rezultoi e provuar nga hetimi se ai ka udhëtuar me automjetin në pronësi të shoqërisë “***” sh.p.k. përpara zhvillimit të këtij gjykimi, lidhur me këtë vendim subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e konfliktit të interesit parashikuar nga neni 5, pika 1, shkronjat “dh”/“v” të ligjit nr. 9367/2005 dhe në bazë të nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga çështja për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

7.11. Subjekti rezultoi gjithashtu se ka qenë vendimmarrës në vendimin nr. ***, datë 7.4.2011, me paditës shoqërinë “***” sh.p.k. dhe palë të paditur Bashkinë Elbasan, me objekt “Përmbushja e detyrimit kontraktor”, ku në përfundim të gjykimit ka vendosur në favor të palës paditëse, shoqërisë “***” sh.p.k., duke pranuar pjesërisht padinë dhe detyruar palën e paditur, Bashkinë Elbasan, të shpërblejë palën paditëse, shoqërinë “***” sh.p.k., në vlerën 80.030.574 lekë.

7.11.1. Duke pasur parasysh nga njëra anë qëllimet dhe veprimet e subjektit të rivlerësimit, që konsistonin në kryerjen e veprimeve juridike të caktuara në qytetin ku ai kryen funksionin e gjyqtarit dhe njihet si i tillë dhe, nga ana tjetër, qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve që, ndër të tjera, është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, përdorimi i automjetit të kësaj shoqërie, nga subjekti pasi ai ka qenë vendimmarrës në vendimin nr. ***, datë 7.4.2011, me paditës shoqërinë “***” sh.p.k. dhe palë të paditur Bashkinë Elbasan, përbën zgjedhje, të cilat jo vetëm nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por e dëmtojnë atë.

7.12. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit kur ka gjykuar çështjen me palë ndërgjyqëse shoqërinë “***” sh.p.k., me objekt “Lëshim urdhri ekzekutimi”, me kërkues shoqërinë “***” sh.p.k. kundër debitorit “***” sh.p.k., duke e vendosur në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

7.12.1. Veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me përdorimin e automjetit të shoqërisë “***” sh.p.k., pasi ka gjykuar çështjen me palë ndërgjyqëse shoqërinë dhe palë të paditur Bashkinë Elbasan, me objekt “Përmbushja e detyrimit kontraktor” ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

8. Përdorimi i automjetit në pronësi të shtetasve K. dhe V. B.

8.1. Gjatë hetimit administrativ, sipas të dhënave të sistemit TIMS, ka rezultuar se subjekti në datën 14.9.2019 ka përdorur automjetin me targa ***, në pronësi të shtetasve K. dhe V. B.

8.2. Komisioni ka hetuar për situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasit e mësipërm dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan u konfirmua se subjekti ka gjykuar çështjen penale nr. ***, datë 12.11.2012, me shtetasin V. B., i akuzuar për veprat penale “plagosje e rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, parashikuar nga neni 88/b i Kodit Penal, si dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal.

8.3. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumente në lidhje me sa, duke pasur parasysh nga njëra anë qëllimet dhe veprimet e subjektit të rivlerësimit që konsistojnë në kryerjen e veprimeve juridike të caktuara në qytetin ku ai kryen funksionin e gjyqtarit dhe njihet si i tillë dhe, nga ana tjetër, qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve që, ndër të tjera, është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, duket se përdorimi nga subjekti i automjetit të shtetasit V. B., pasi ka shqyrtuar çështjen penale nr. ***, datë 12.11.2012, përbën zgjedhje, të cilat, nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por e dëmtojnë atë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

8.4. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë shpjegim apo provë për të argumentuar konstatimet e mësipërme.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

8.5. Komisioni vlerësoi përdorimin e automjetit nga subjekti i rivlerësimit lidhur me qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve që, ndër të tjera, është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

8.6. Përdorimi i automjetit të shtetasit V. B., nga subjekti i rivlerësimit, pasi ky i fundit kishte shqyrtuar çështjen penale nr. ***, datë 12.11.2012, me këtë shtetas, akuzuar për veprat penale “plagosje e rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, parashikuar nga neni 88/b i Kodit Penal, “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, përbën zgjedhje, e cila jo vetëm nuk shërben në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, në kuptim të parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

9. Konkluzion i Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë

Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë trupi gjykues arrin në konkluzionin se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vlerën totale prej -11.081.455 lekësh, për periudhën e deklaramit.

b) Mungesa e burimeve të ligjshme financiare në vlerën totale prej -11.081.455 lekësh, për periudhën e deklaramit e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61 dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

c) Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të ndërtimit të banesës dy kate + bodrum + nënçati 101 m²/kati, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

d) Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të pjesës takuese në pasurinë bodrum, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

e) Subjekti i rivlerësimit lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e pjesës së tij takuese në pasurinë bodrum gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

f) Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve për të justifikuar burimin e ligjshëm të automjetit tip “***”, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

g) Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit kur ka gjykuar çështjet me palë ndërgjyqëse shoqëritë “***” sh.p.k. dhe “***” sh.p.k., duke u ndodhur në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

h) Veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me automjetet, arsyetuar në pikat 4, 6, 7 dhe 8 të këtij vendimi e vendosin atë në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 i ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se bazuar në konkluzionet e arritura më lart, në konsideratë të standardeve të vendosura nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Tafa, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

10. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka paraqitur pranë Komisionit raportin e përditësuar të deklasifikuar pjesërisht, ku informon se:

“Për subjektin e rivlerësimit Taulant Dh. T. disponohen të dhëna ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive dhe ushtrim ndikimi të paligjshëm në disa procese gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit Taulant Tafa dyshohet se ka pasur kontakte të papërshtatshme me dy persona të përfshirë në trafik, ku me njërin prej tyre dyshohet se ka pasur edhe marrëdhënie biznesi.

Për subjektin e rivlerësimit Taulant Tafa arsyetohet të merren parasysh elementet që evidentojnë përfshirjen në veprimtari korruptive, pasi në frymën kundërkorrupsion të ligjit nr. 84/2016 vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit”.

10.1. Në përfundim, pas rishikimit të raportit fillestar, Grupi i Punës i DSIK-së ka konstatuar papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Taulant Tafa.

10.2. Komisioni hetoi nëse subjekti ka pasur lidhje apo kontakte jo të rastësishme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

10.3. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 5, pyeti subjektin e rivlerësimit nëse: *“Ka pasur njohje me shtetasin E. S., nëse kanë udhëtuar ndonjëherë në shoqërinë e njëri-tjetrit, nëse ka komunikuar ndonjëherë në telefon me këtë shtetas apo nëse është takuar, nëse po, të japë shpjegime nëse komunikimi apo takimi ka qenë për arsye pune apo thjesht shoqërore, nëse kanë pasur me njëri-tjetrin shoqëri të vazhdueshme ose jo, personale apo familjare”.*

10.4 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 5, ka deklaruar: *“Me shtetasin E. S. dhe familjen e tij kam pasur njohje të mëparshme, që rrjedh që në periudhën e fëmijërisë dhe adoleshencës, për shkak se në atë kohë kemi qenë banorë të së njëjtës lagje. Nuk kemi udhëtuar ndonjëherë në shoqërinë e njëri-tjetrit. Duke qenë banorë të qytetit të Elbasanit, pasur parasysh dhe madhësinë apo shtrirjen e komunitetit përkatës, pas viteve 2002 ka qëlluar që në rrethana krejt rastësore të jem takuar me këtë shtetas, kjo edhe për shkak të njohjes së mëparshme, por asnjëherë për arsye pune.*

Aq e vërtetë është kjo e fundit, pasi në vitin 2017 gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me short më ka rënë për të gjykuar çështjen penale që i

*përkiste kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Elbasan, me objekt “Njohje e vendimit penal të huaj”, dhënë ndaj shtetasit E. S. Në këtë moment jam vënë në dijeni për faktin që ky shtetas gjatë periudhës që kishte qenë emigrant në shtetin e Italisë, ishte marrë me aktivitete kriminale dhe ishte person i dënuar nga autoritetet e drejtësisë italiane. Pasi mora dijeni dhe ndodhur para këtij fakti, në datën 25.7.2017 kam paraqitur kërkesë pranë kryetarit të gjykatës për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, sipas dispozitave ligjore procedurale penale, kërkesë e cila, me vendimin përkatës, datë 26.7.2017, të kryetarit të gjykatës, është miratuar, dhe çështja ndaj shtetasit E. S. është gjykuar nga një trup tjetër gjyqësor, i cili ka disponuar me vendimin nr. ***, datë 27.9.2017”.*

10.5. Në vijim të shpjegimeve, subjekti ka vendosur në dispozicion: (i) vendimin gjyqësor nr. ***, datë 27.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (ii) kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes; (iii) vendimin mbi pranimin e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi i çështjes.

10.6. Nga verifikimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 27.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për “njohje të vendimit penal të huaj”, dhënë ndaj shtetasit E. S., rezulton se ky shtetas është dënuar me vendimin nr. ***, datë 2.3.2003, të Gjykatës së Apelit Brescia, Itali, marrë formë të prerë më 2.3.2009, për veprën penale 110 të Kodit Penal Italian, vepra këto të cilat konvertohen sipas nenit 283/1 “prodhim dhe shitje e narkotikëve” të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

10.7. Vepra penale për të cilën është akuzuar dhe dënuar ky shtetas, përfshihet në parashikimet e pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin thuhet shprehimisht: *“Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: (a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; (b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata, pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet”.*

Bazuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime në lidhje me kontaktet me këtë shtetas dhe detyrimin për deklarimin e tij në deklaratën e kontrollit të figurës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

10.8. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi se: *“Ashtu siç është cituar edhe në vendimin e dënimit të tij, ka rezultuar se shtetasi E. S. është dënuar në vitin 2003 në Itali. Pra, në çdo rast, ky fakt e përjashton mundësinë e marrjes dijeni nga ana ime për këtë fakt.*

10.9. *Nuk ka rezultuar e provuar që unë, subjekti i rivlerësimit, të kem kryer ndonjë udhëtim me ndonjë automjet apo në shoqërinë e shtetasit E. S., apo të ndonjë prej familjarëve të tij.*

10.10. *Në rastin konkret, nga gjithë trajtimi i mësipërm, qartësisht dhe bindshëm provohet fakti që nuk kam pasur dijeni rreth dënimit në shtet të huaj të shtetasit E. S., i larguar nga vendlindja pas viteve 1990 (de facto) në emigrim, i proceduar në vitin 2003, me të cilin nuk kam pasur kontakte; për të cilin ky fakt nuk është bërë publik në median e shkruar dhe vizive, me të cilin nuk kam bërë asnjë udhëtim jashtë shtetit. Si rrjedhim, kjo gjetje nuk mund të konsiderohet deklarim i pamjaftueshëm lidhur me kriterin e figurës dhe duhet të konsiderohet se e kam plotësuar me vërtetësi atë”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.11. Komisioni, nga vlerësimi tërësor i rrethanave, fakteve, provave dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me kriterin e figurës, vlerëson se shtetasi E. S. rezulton të ketë qenë person i përfshirë në krimin e organizuar.

10.12. Faktet e provuara nga hetimi administrativ nuk ishin të mjaftueshme për të arritur në një konkluzion lidhur me kontakt të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni, lidhur me kriterin e figurës në përputhje me ligjin nr. 84/2016, e shtriu hetimin administrativ duke kërkuar informacion në lidhje me çështjet si vijon:

10.13. Lidhur me vendimin penal nr. ***

Me shkresën nr. *** prot., datë 18.11.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan vendosi në dispozicion kopje të fashikullit të procedimit penal nr. ***.

Nga shqyrtimi rezulton se në datën 28.5.2020 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq në përfundim të hetimit të procedimit penal nr. *** kundër të pandehurit A. Ç., i dyshuar për veprën penale “dhunë në familje”, e parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal, në dëm të viktimës E. Ç. Subjekti i rivlerësimit është përcaktuar me short elektronik në cilësinë e gjyqtarit për gjykimin në themel të çështjes.

10.13.1. Nga analizimi i vendimit rezulton se:

Në datën 9.12.2020, me vendimin nr. 981, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes referuar rrethanave, si: (i) rrezikshmëria e të pandehurit, shkalla e fajit, gjendja sociale, familjare dhe ekonomike; (ii) fakti që është person i padënuar më parë; (iii) fakti që marrëdhëniet me viktimën momentalisht janë të normalizuara, si dhe rrethana të tjera që do të mbahen parasysh në kuptim të nenit 49 të Kodit Penal; si dhe (iv) mungesa e rrethanave rënduese – ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit A. Ç. dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim sipas nenit 130/a/4 të Kodit Penal dhe, në bazë të neneve 48/ç dhe 49 të Kodit Penal. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale – dënimin e të pandehurit me 8 muaj burgim. Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal – pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim të të pandehurit A. A. Ç. dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik”*.

Nga analizimi duket se arsyetimi i vendimit nuk është bërë në përputhje me provat e administruara në gjykim dhe me faktet e rrethanat që janë provuar gjatë procesit gjyqësor. Gjyqtari në caktimin e vendimit merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Faktet dhe rrethanat duket se janë parashtruar vetëm për t’iu përshtatur plotësisht të kërkesave të nenit 63 të Kodit Penal. Nuk janë respektuar një tërësi dispozitash, si neni 47, neni 48, paragrafi i dytë, sipas të cilit rrethanat lehtësuese të parashikuara në shkronjën “e” të paragrafit të parë të këtij neni (normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit) nuk lehtësojnë dënimin e një personi që ka kryer një vepër penale ndaj fëmijëve apo një vepër penale të dhunës në familje.

Në vendim, subjekti, si rrethanë lehtësuese, ka arsyetuar faktin që i pandehuri është person “i padënuar” më parë, kur sipas certifikatës së gjendjes gjyqësore nr. *** prot., datë 26.5.2020, administruar në dosje, rezulton se i pandehuri ka qenë “i dënuar”.

Sa më sipër, subjektit iu kërkuar të japë shpjegime lidhur me sa duket se masa e dënimit të caktuar nga gjykata është dhënë në keqinterpretim të neneve 47, 48 dhe 68 të Kodit Penal dhe, për rrjedhim, ka cenuar parimin e proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i Kodit Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës.

10.13.2. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi: “Sipas akteve të ndodhura në dosje, në përfundim të gjykimit nga ana e gjykatës është vendosur e njëjta masë dënimi kërkuar dhe nga akuza, 1 vit burgim dhe, në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, është dënuar përfundimisht me 8 muaj burgim. Po ashtu, nga vetë akuza, në përfundim, është kërkuar që për shkak të rrethanave të çështjes ndaj të pandehurit, të bëhet pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, duke u aplikuar si dënim alternativ ai i parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal. Në vazhdim, edhe nga gjykata është disponuar në të njëjtën mënyrë si akuza, ndaj të pandehurit është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, duke aplikuar si dënim alternativ atë të parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal.

Vlen të theksoj se vendimi është i formës së prerë dhe nuk është ankimuar nga palët, çka tregon që palët nuk kanë pasur kundërshti në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës. Në vendimmarrjen e saj, gjykata ka vlerësuar rrethanat konkrete familjare, faktin që i pandehuri është kryefamiljar i një familjeje me dy fëmijë që kanë nevojë për mjete financiare për jetesë, që nga rrethanat mund t’i siguronte vetëm kryefamiljari (i pandehuri); vlerësimin pozitiv nga pushteti vendor, Bashkia Elbasan; situatën mjaft të rënduar ekonomike të familjes së të pandehurit (rezultonte debitor ndaj BKT-së – kredi); qenia e të pandehurit i lirë, si kryefamiljar dhe i aftë për punë, ishte e vetmja e ardhur që mund t’i vinte në ndihmë familjes, parë në raport të ngushtë dhe me faktin që marrëdhëniet midis të pandehurit dhe bashkëshortes (viktimë në çështjen penale) ishin mjaft të mira apo, siç është shprehur vetë viktima në seancë gjyqësore, të shkëlqyera.

Ndonëse në rastin e veprave penale të parashikuara nga neni 130/a i Kodit Penal marrëdhëniet e normalizuara midis të pandehurit dhe viktimës nuk konsiderohen si rrethana në kuptim të nenit 48 të Kodit Penal, kjo rrethanë është vlerësuar në harmoni me provat e tjera, duke vendosur në radhë të parë interesat e familjes dhe interesin më të lartë të fëmijëve, në mbarëvajtjen e mëpasshme të jetës familjare. Elemente të tilla, si mënyra e jetesës dhe nevojat, veçanërisht ato që lidhen me familjen... rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe sjelljes pas kryerjes së veprës penale, duhet të evidentohen posaçërisht apo në grup, me qëllim justifikimin racional të aplikimit të urdhërimeve të neneve 59 apo 63 të Kodit Penal”.

Subjekti, në cilësinë e provës, ka depozituar: (i) vendimin gjyqësor nr. ***, datë 9.12.2020; (ii) procesverbalin gjyqësor; (iii) deklaratën noteriale të viktimës E. Ç.; (iv) vërtetimin datë 24.2.2020, Bashkia Elbasan; (v) certifikatën familjare; (vi) vërtetimin datë 24.2.2020, të lëshuar nga BKT-ja Elbasan.

10.13.3. Arsyetimi ligjor

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancë dëgjimore, konstaton se argumentet e subjektit nuk janë bindëse dhe nuk bazohen në provat e administruara.

Komisioni vlerëson se në këtë vendim, nga subjekti, pavarësisht provave të administruara dhe fakteve të provuara, në procesin gjyqësor, nuk është mbajtur në konsideratë në caktimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim, neni 48 i Kodit Penal, sipas të cilit rrethanat lehtësuese të parashikuara në shkronjën “e” të këtij neni, nuk lehtësojnë dënimin e një personi që ka kryer një vepër penale të dhunës në familje.

Komisioni vlerëson se në këtë vendim, nga subjekti nuk është mbajtur në konsideratë në caktimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim se i pandehuri, referuar certifikatës së gjendjes gjyqësore nr. *** prot., datë 26.5.2020, ka qenë “i dënuar”.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit në këtë vendimmarrje, është gjetur në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material dhe procedural.

Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë vendim, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë subjekti, krijoi bindjen se informacioni që disponohej në ngarkim të subjektit të rivlerësimit sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë vendimmarrje ishte i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete.

10.14. Lidhur me vendimin penal nr. *, datë 24.12.2018**

Kërkuesi Sh. H. është dënuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda Tiranë me 8 vjet burgim për veprën penale “trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, pasi është ekzekutuar vendimi penal, kërkuesi në datën 17.7.2018 i është drejtuar me kërkesë “për lirim me kusht” Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

10.14.1. Nga analizimi i vendimit rezulton se:

Në datën 24.12.2018, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, me vendimin nr. 823, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës; lirimin me kusht të kërkuesit Sh. H., duke ia dhënë kohën e pavuajtur të dënimit prej 1 viti, 7 muajsh dhe 12 ditësh, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mos kryejë veprë tjetër penale me dashje. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit, nëse ndaj tij nuk zbatohet masa e sigurimit “arrest në burg” ose dënime me burgim për shkaqe të tjera...”*

Subjekti i rivlerësimit e ka bazuar vendimin për lirimin e të dënuarit në nenin 64 të Kodit Penal, i cili parashikon se: *“I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale; jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim; jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni. Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje...”*

Në argumentimin e vendimit, subjekti i rivlerësimit i ka dhënë rëndësi dhe ka konsideruar si “arsye të veçanta” gjendjen ekonomike dhe shëndetësore të familjes së kërkuesit dhe vetë kërkuesit, në kundërshtim me përcaktimin e vendimit unifikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit: *“Në shumë çështje gjyqësore me objekt lirimin me kusht janë pretenduar si “arsye të veçanta” rrethana të tilla, si për shembull gjendja familjare e rënduar e të dënuarit; sëmundja e rëndë e prindërve apo e të afërmve të tjerë; qenia me fëmijë të mitur dhe me bashkëshortë në ngarkesë të të dënuarit.*

Në vlerësimin e Kolegjeve të Bashkuara, kjo qasje është e papranueshme dhe e gabuar. Kjo pasi, në interpretimin që i kanë bërë shprehjes “arsye të veçanta”, gjykatat më të ulëta efektivisht kanë shtuar me pa të drejtë një kriter të jashtëm të paparashikuar nga ligji si kusht ndalues për efekt të pranimit të kërkesës për lirim me kusht. Megjithatë, siç edhe do të sqarohet më poshtë, Kolegjet vlerësojnë se rrethanat që kanë të bëjnë me familjarët e të dënuarit mund të merren parasysh nga ana e gjykatave jo si kusht thelbësor, por si rrethanë që shkon në favor të kërkesës për lirim me kusht, në drejtim të analizës së gjykatës për riintegrimin e plotë të të dënuarit pas lirimit”.

Subjekti duket se nuk ka zbatuar vendimin unifikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me kuptimin dhe zbatimin në praktikë të shprehjes “arsye të veçanta”, të parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal.

Në dinamikën e vuajtjes së dënimit, paraqitur nga IEVP-ja gjatë seancës gjyqësore për të dënuarin, rezulton se ai ka përfituar 3 muaj e 18 ditë ulje dënimi si pasojë e punësimit në IEVP, pavarësisht se në dosjen e administruar nuk ka prova që e provojnë këtë fakt. Subjekti i

rivlerësimin gjatë shqyrtimit gjyqësor duhet që në vlerësimin dhe pranimin e kërkesës për lirim me kusht të kërkonte dhe administronte provat që provonin punësimin e të dënuarit në IEVP dhe të përfitimit të 3 muajve e 18 ditësh ulje, në mënyrë që të provonte plotësimin e kërkesës së nenit 64 të Kodit Penal, sipas të cilit i dënuari mund të lirohet me kusht nëse ka vuajtur jo më pak se tre të katërtat e dënimit, të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji.

Sa më sipër, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me këto konstatime të Komisionit.

10.14.2. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimin

Subjekti i rivlerësimin, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Vlen të evidentoj faktin se sipas akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, nga ana e palëve në seancë, prokurorit, është kërkuar pranimi i kërkesës dhe lirimi me kusht i të dënuarit; nga ana e Komisionit të vlerësimin të IEVP-së është referuar sjellja e mirë dhe korrekte e të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit, duke kërkuar pranimin e kërkesës; nga ana e shërbimit të provës, pasi janë referuar rrethanat në tërësi, është konkluduar se riintegrimi i të dënuarit në shoqëri është i mundshëm, duke kërkuar pranimin e kërkesës së të dënuarit për lirimin me kusht. Ashtu siç pasqyrohet edhe në arsyetimin e vendimit gjyqësor, vetë ligjvënësi, duke përdorur termin arsye e veçantë, ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato, duke e lënë gjithmonë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që paraqiten, por gjithmonë ato janë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirimimit me kusht, e që ka të bëjë me rehabilitimin e të dënuarit.*

*Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër, veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi i edukimit dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Rol të rëndësishëm në vlerësimin nga gjykata të rrethanave të veçanta merr vlerësimi i sjelljes së të dënuarit gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit, që, pavarësisht subjektivitetit të gjykatës, duhet të jetë i bazuar në prova konkrete, përderisa i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, qëndrim i mbajtur edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. ***, datë 5.2.2014. Pra, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. ***, datë 5.2.2014, termin arsye e veçantë e lidh me rrethana, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi i edukimit dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri, ku rol primar merr vlerësimi i sjelljes së të dënuarit gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit.*

Siç u relatua më sipër, nga ana e Komisionit të vlerësimin të IEVP-së është referuar sjellja e mirë dhe korrekte e të dënuarit, qëndrim të cilin e ka mbajtur edhe përfaqësuesi i saj në gjykim.

*Po ashtu, sipas raportit të paraqitur nga ana e shërbimit të provës është konkluduar se riintegrimi i të dënuarit në shoqëri është i mundshëm, çka tregon se nga ana ime është zbatuar drejt qëndrimi i mbajtur edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. ***, datë 5.2.2014, ashtu siç janë marrë parasysh edhe rrethana që lidhen me situatën sociale dhe ato që lidhen me familjen e të dënuarit”.*

Subjekti, në cilësinë e provës, ka depozituar: (i) vendim gjyqësor nr. ***, datë 24.12.2018; (ii) raporti i vlerësimin të ZVSH Provës Elbasan; (iii) vlerësim sjelljeje datë 21.9.2018, nga IEVP-ja Peqin.

10.14.3. Arsyetimi ligjor

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, arsyeton se:

Komisioni vlerëson se vendimi i subjektit është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit material dhe procedural penal (të ligjit nr. 8328/1998, i ndryshuar, nenit 64 të Kodit Penal dhe nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale), për sa i takon çmuarjes se provave dhe vlerësimin të kushteve dhe kritereve ligjore që duhet të plotësohen nga i dënuari në aplikimin e institutit të lirimimit me kusht sipas nenit 64 të Kodit Penal.

Në dosjen e administruar rezulton se IEVP-ja ka paraqitur prova që provojnë uljet e tjera të dënimit të përfituara nga i dënuari, përveçse provave që të provojnë uljen e dënimit për shkak të punësimit të të dënuarit në institucion, të cilat mungojnë në dosje.

Arsyetimi i subjektit se sipas akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore rezulton se nga ana e palëve në seancë nuk është ngritur ndonjë pretendim, në mënyrë që gjykata t'i nënshtrohej hetimit apo debatit gjyqësor, nuk qëndron, pasi në çdo proces penal, sipas nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj për të arritur në konkluzione të drejta, ndaj, paraqet rëndësi marrja dhe analiza tërësore e provave të paraqitura nga palët.

Për më tepër, Komisioni vëren se ditët e punës, të cilat i janë ulur shtetasit për shkak të punësimit, nuk duhen llogaritur si të tilla pasi ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar, i cili rregullon aktualisht të gjitha të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve në nenin 34 të tij dhe VKM-ja Nr. 3003, datë 25.3.2009, "Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve" në nenin 83 të saj nuk pranojnë faktin që të dënuarit t'i ulen ditët dhe koha e dënimit me burgim për faktin se punon në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit në këtë vendimmarrje, është gjetur në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material dhe procedural për zbatimin e nenit 64 të Kodit Penal.

Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë vendim, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë subjekti, krijoi bindjen se informacioni që disponohej në ngarkim të subjektit të rivlerësimit sipas kërkesave të shkronjave "b" dhe "c" të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë vendimmarrje ishte i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete.

10.15. Lidhur me vendimin penal nr. ***

10.15.1. Komisioni administroi dosjen për çështjen penale nr. ***. Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se në datën 11.11.2004, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka paraqitur për gjykim kërkesën me objekt "Deklarimi fajtor, dërgimi në gjyq i procedimit penal nr. ***, regjistruar 2004, në ngarkim të të pandehurve M. H., E. I., S. M., të akuzuar për kryerjen e veprës penale "prodhim dhe shitje e narkotikëve në bashkëpunim", të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe E. L., akuzuar për kryerjen e veprës penale "prodhim dhe shitje e narkotikëve", të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal".

10.15.1. Nga analizimi i vendimit rezulton se:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 23.3.2005, me trupin gjykues të përbërë nga tre anëtarë (subjekti i rivlerësimit – anëtar i trupit gjykues) ka vendosur: *"Deklarimin fajtor të S. M., të akuzuar për kryerjen e veprës penale "prodhim dhe shitje e narkotikëve në bashkëpunim", të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe kryer më shumë se një herë, të parashikuar nga nenet 283/2 e 51 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim.*

Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve E. L., M. H., E. I., akuzuar për kryerjen e veprës penale "prodhim dhe shitje e narkotikëve, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale..."

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka paraqitur ankimin nr. *** prot., datë 31.3.2005, kundër vendimit penal nr. ***, në datën 23.3.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Gjykata e Apelit Elbasan, me vendimin nr. ***, në datën 12.12.2005, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, në datën 23.3.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor*

Elbasan, sa u përket shtetasve S. M., E. L. dhe E. I. Ndryshimin e vendimit sa i përket shtetasit M. H. dhe deklarinin fajtor për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve në bashkëpunim”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim...”.

Prokuroria e Apelit Durrës ka paraqitur ankim/rekurs me nr. *** prot., datë 5.1.2006, kundër vendimit penal nr. ***, në datën 12.12.2005, të Gjykatës së Apelit Elbasan.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 16.1.2008, në mënyrë të përmbledhur ka vendosur: *“Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në mangësitë e konstatuara për sa u përket procedurave që u ndoqën dhe mbi të cilat u bazuan gjykatat, që sasitë prej 12.3, 11.3 dhe 8.8 g (për gjykatën e shkallës së parë) dhe 11.3 e 8.8 g (për Gjykatën e Apelit), sipas tyre u konsideruan për përdorim vetjak dhe në doza të vogla, si dhe në kundërshtitë logjike që ka përdorur për ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit arriti në përfundimin se përjashtoi pjesën që i përket të gjykuarit S., të dyja këto vendime janë të pabazuara dhe duhet të cenohen. U arrit në përfundimin e mësipërm, pasi, sikurse rezulton nga aktet, përfundimi i gjykatave lidhur me kuptimin e rrethanave ligjore të “përdorimit vetjak” dhe atij “në doza të vogla”, prania e të cilave passjell mungesën e përgjegjësisë penale për personin që, në kundërshtim me ligjin mban substancë narkotike, u arrit prej tyre vetëm mbi bazën e konkluzioneve sipërfaqësore të bëra në seancën gjyqësore, nëpërmjet shpjegimeve verbale të saj, nga specialistja toksikologe znj. B., për pyetjen e së cilës, megjithëse në procesverbalin gjyqësor (f. 44) figuron në rolin e ekspertes, nuk figuron të jenë respektuar kërkesat e dispozitave të neneve 179, 185 etj. (vendimi i organit procedues për caktimin...; mendimi i ekspertit jepet me shkrim etj.)”.*

Sa më sipër, subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me konstatimet e Gjykatës së Lartë.

10.15.2. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Nga sa është parashtruar në raport nga vetë Komisioni, vlerësimi i aftësive profesionale për vendime gjyqësore mund të shtrihet nga data 1.1.2006 e në vazhdim, referuar kjo edhe pikës 3 të nenit 41. Konstatohet që vendimi gjyqësor mban datën 23.3.2005. Sa më sipër, vlerësoj se ky vendim nuk mund t’i nënshtrohet analizës nga ana e Komisionit”.*

10.15.3. Arsytimi ligjor

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti vlerëson se pretendimi i subjektit se ky vendim nuk mund t’i nënshtrohet analizës nga ana e Komisionit, nuk qëndron, pasi referuar pikës 3 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, është në diskrecion të Komisionit të vendosë/çmojë se vlerësimi i aftësive profesionale për vendime gjyqësore mund të shtrihet nga data 1.1.2006 e në vazhdim.

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, vlerësoi se subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me konstatimet e pasqyruara në vendimin e Gjykatës së Lartë.

Komisioni vlerësoi se përfundimi i arritur në vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Elbasan nuk është i bazuar në ligj dhe në prova, pasi në rastin konkret, rezulton se:

- nuk janë vlerësuar drejt provat bazuar në nenet 8/a dhe 152 të Kodit të Procedurës Penale, pasi sikurse rezulton nga aktet, përfundimi i gjykatës lidhur me kuptimin e rrethanave ligjore të “përdorimit vetjak” dhe atij “në doza të vogla” është arritur vetëm mbi bazën e konkluzioneve sipërfaqësore të bëra në seancën gjyqësore dhe konkluzionet e specialistes kanë qenë të pamjaftueshme, pasi nuk janë përmendur prej saj argumente të dokumentuara shkencore; si dhe

- është zbatuar gabim ligji procedural, pasi nuk figuron që të jenë respektuar kërkesat e dispozitave të neneve 179 dhe 185 të Kodit të Procedurës Penale (vendimi i organit procedues për caktimin; mendimi i ekspertit jepet me shkrim, etj.).

Trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe sa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 16.1.2008, ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, marrë nga subjekti i rivlerësimit, është i pabazuar dhe duhet të cenohet.

Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit në këtë vendimmarrje, është gjetur në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material dhe procedural.

Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë vendim, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë subjekti, krijoi bindjen se informacioni që disponohet në ngarkim të subjektit të rivlerësimit sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë vendimmarrje ishte i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete.

11. Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

11.1. Komisioni, pas hetimit të kryer, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjet e arsyetuara më lart për vlerësimin e kontrollit të figurës, dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve e dhëna nga subjekti, krijoi bindjen se informacionet që disponoheshin në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ishin bazuar në fakte dhe rrethana konkrete.

11.2. Në vlerësimin e trupit gjykues lidhur me këtë kriter u mbajt dhe sa ka rezultuar nga aksesit i trupit gjykues të Komisionit, së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar të ONM-së, në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, që i përket praktikës së verifikimit të kryer nga Shërbimi Informativ Shtetëror për kontrollin e kriterit të figurës, për subjektin e rivlerësimit me qëllim verifikimin e burimeve të informacionit që kanë shërbyer për arritjen e konkluzioneve të paraqitura nga Grupi i Punës në raportin e DSIK-së.

11.3. Aksesimi i informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror” u krye në mënyrë të drejtpërdrejtë duke u vënë në dispozicion të trupit gjykues të Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, dosjet që i përkisnin praktikave së verifikimit të kryer nga SHISH-i për kriterin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit.

11.4. Në kuadër të standardit të vendosur nga jurisprudenca e GJEDNJ-së në çështjen *Regner* kundër Republikës Çeke, njohja me provat e administruara gjatë hetimit të Komisionit, për shkak të natyrës së informacionit që mbarte edhe kushteve specifike të ruajtjes, administrimit dhe përdorimit të tij, u krye pranë ambienteve të autoritetit kompetent shtetëror, ku trupi gjykues verifikoi në vend të njëjtin informacion të aksesuar nga Grupi i Punës së DSIK-së, si dhe burimet e informacionit që shërbyen për hartimin e raportit të Grupit të Punës të DSIK-së.

11.5. Në përfundim, në këndvështrimin e përgjithshëm edhe nëse përfundimi i arritur nga trupi gjykues në pikën 11.1. të këtij vendimi nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Taulant Tafa, trupi gjykues vlerëson se mospërmbushja e rregullt e detyrës nga subjekti i rivlerësimit cenon pastërtinë e figurës së subjektit dhe shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

12. Vlerësimi i aftësive profesionale nga organi ndihmës për vlerësimin profesional, u krye nga KLGJ-ja bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në: formularin e vetëvlerësimit, në 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor. Nga të tria dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit nuk rezultuan problematika, ndërkohë që gjetjet nga vëzhgimi i këtyre 5 dosjeve përshkruhen si vijon:

12.1. Dosja 1 – çështja penale nr. *** akti, datë 14.10.2013 regjistrimi, që i përket kërkuesit E. P., me objekt “Ulja e masës së dënimit penal me burgim”, bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 8328/1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 19.11.2013.

Nga analizimi i Grupit të Punës konstatohet se:

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit Taulant Tafa në sekretarinë gjyqësore në datën 27.11.2013 – pas 8 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Prokurori nuk është thirrur dhe nuk është njoftuar në shkelje të nenit 471/4 të Kodit të Procedurës Penale. Në zhvillimin e seancës gjyqësore nuk është respektuar parimi i kontradiktoritetit, pasi seanca gjyqësore është kryer pa pjesëmarrjen e prokurorit, ndonëse neni 471, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale cakton pjesëmarrje të detyrueshme të tij. Seancat gjyqësore nuk dokumentohet të jenë zhvilluar në sallë gjykimi, dhe nuk janë regjistruar audio.

Sa më sipër, subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë shpjegim apo provë për të argumentuar konstatimet e mësipërme.

12.2. Dosja 2 – çështja penale nr. *** (***) regj. them., datë 11.5.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë kundër të pandehurave F. L. dhe K. F., të akuzuara për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 23.9.2015.

Nga analizimi i Grupit të Punës konstatohet se:

Seanca e dytë gjyqësore e datës 18.6.2015 është dokumentuar me procesverbal letër, pa regjistrim audio. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit Taulant Tafa në sekretarinë gjyqësore në datën 5.10.2015 – pas 12 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Sa më sipër, subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë shpjegim apo provë për të argumentuar konstatimet e mësipërme.

12.3. Dosja 3 – çështja penale nr. *** (***) regj. them., datë 2.9.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë kundër të pandehurit A. H., i akuzuar për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.10.2015. Ka marrë formë të prerë më 20.10.2015.

Nga analizimi i Grupit të Punës konstatohet se:

Seancat gjyqësore nuk dokumentohet të jenë zhvilluar në sallë dhe nuk janë regjistruar audio. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit Taulant Tafa në sekretarinë gjyqësore në datën 14.10.2015 – pas 7 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Sa më sipër, subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë shpjegim apo provë për të argumentuar konstatimet e mësipërme.

12.4. Dosja 4 – çështja penale nr. *** (***) regj. them., datë 29.10.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë kundër të pandehurit Xh. S., i akuzuar për veprën penale “goditje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 19.11.2015. Çështja është depozituar në gjykatë në datën 27.10.2015 dhe është regjistruar në datën 29.10.2015. Me shortin e datës 28.10.2015, çështja i është caktuar gjyqtarit Taulant Tafa. Veprimi për caktimin e seancës dhe data e seancës respektojnë afatet 10-ditore të përcaktuara nga neni 333 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit sipas akuzës, dënimin e tij me burgim dhe pas uljes me 1/3 nga gjykimi i shkurtuar, dënimin e tij përfundimisht me 2 muaj burgim, duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të tij dhe vënien e të pandehurit në provë për 2 vjet. Kundër vendimit nuk është ushtruar ankim dhe ka marrë formë të prerë më 1.12.2015.

Nga analizimi i Grupit të Punës konstatohet se:

Seancat gjyqësore nuk dokumentohet të jenë zhvilluar në sallë dhe nuk janë regjistruar audio. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit Taulant Tafa në sekretarinë gjyqësore në datën 25.11.2015 – pas 6 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë shpjegim apo provë për të argumentuar konstatimet e mësipërme.

12.5. Dosja 5 – çështja penale nr. *** (***) regj. them., datë 28.1.2016 regjistrimi, që i përket Prokurorisë kundër të pandehurit L. Gj., akuzuar për kryerjen e veprës penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 28.1.2016. Ky vendim është dhënë në emër të Republikës, ndonëse nuk është vendim përfundimtar themeli, duke mos respektuar nenin 112/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 142/1 dhe 146/1 të Kushtetutës. Gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit sipas akuzës, dënimin e tij me burgim dhe pas uljes së dënimit me 1/3 dënimin e tij përfundimisht me 20 ditë burgim, si dhe zëvendësimin e dënimit me burgim me 70.000 lekë në favor të shtetit, sipas nenit 53/a të Kodit Penal. Kundër vendimit nuk është ushtruar ankim. Ka marrë formë të prerë në datën 8.2.2016.

Nga analizimi i Grupit të Punës konstatohet se:

Seanca gjyqësore nuk dokumentohet të jetë zhvilluar në sallë dhe nuk janë regjistruar audio. Vendimi për vlefhtësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj të pandehurit L. Gj. është dhënë në emër të Republikës, ndonëse nuk është vendim përfundimtar themeli, duke mos respektuar nenin 112/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 142/1 dhe 146/1 të Kushtetutës.

Sa më sipër, subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë shpjegim apo provë për të argumentuar konstatimet e mësipërme.

12.6 Konkluzioni lidhur me vlerësimin profesional

Tupi gjykues vlerëson se problematikat, lidhur me dosjet e shortuara, referuar nga analizimi i tyre prej Grupit të Punës, afektojnë kriterin e vlerësimit të parashikuar nga neni 74, pikat 2, 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016.

Në kuptim të nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, neni 72 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përcaktuar indikatorët mbi të cilët vlerësohen aftësitë profesionale të gjyqtarit. Në pikën 2 të kësaj dispozite parashikohet si indikator aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin. Mangësitë e konstatuara në vendimet e analizuara të subjektit afektojnë indikatorin e parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

Trupi gjykues vlerëson se edhe nëse mangësitë e konstatuara në vendimet e analizuara të subjektit, në dosjet e shortuara nuk do të mjaftonin për të kualifikuar subjektin të paaftë profesionalisht, sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, referuar problematikave dhe mangësive të evidentuara, në një vlerësim tërësor të rrethanave dhe procedurave ato do të ishin të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

D. DENONCIMET

13. Bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ka analizuar denoncimet për subjektin e rivlerësimit dhe lidhur me denoncimin e shtetasit A. B., regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 8.10.2020, i cili denonconte shkelje të subjektit të rivlerësimit në disa dosje gjyqësore, ka analizuar vendimet e subjektit të rivlerësimit, si më poshtë vijon:

13.1. Lidhur me vendimin për zëvendësimin e masës së sigurisë marrë në datë 29.1.2016

Denoncuesi, në lidhje me këtë vendim, denoncon se:

Subjekti i rivlerësimit është caktuar si anëtar i trupit gjykues pa short elektronik të rregullt.

Subjekti është në konflikt interesi me të pandehurin sipas neneve 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale për shkak të marrëdhënieve të punës me kunatën dhe bashkëshorten e të pandehurit.

Në kundërshtim me rregullat e nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale dhe pa bërë ekspertim mjekësor gjykata me anëtar edhe subjektin ka zëvendësuar masën e sigurimit me “arrest në burg”.

Gjykata ka zvarritur gjykimin qëllimisht deri në dhënien e dënimit përfundimtar për të favorizuar masën e dënimit me burgim që kjo masë dënimi të llogaritej saktë me qëndrimin e tij me “arrest në shtëpi”.

Vendimi ka mangësi dhe dobësi në analizën dhe argumentimin e bindshëm e logjik të qëndrimit të tij për cilësimin ligjor të veprës penale, si dhe nuk ka çmuar provat dhe vlerën e tyre konform nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan vendosi në dispozicion vendimin nga ku rezultoi se:

Në datën 22.10.2015 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan paraqiti kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg me afat 30 ditë”, duke pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, rrethanat në të cilat janë kryer ato dhe pasojën e ardhur.

Me vendimin nr. ***, datë 24.10.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (gjyqtari i hetimeve paraprake – GJHP) vendosi: “Vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit ndaj shtetasit S. S., duke

pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, rrethanat në të cilat janë kryer ato, pasojën e ardhur, si dhe ka qenë i dënuar 4 herë”.

Në datën 22.11.2015 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke qenë se masa “arrest me burg” mbaron në datën 23.11.2015, paraqet kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg me afat 30 ditë duke filluar nga data 23.11.2015”, duke pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, shtetasi ka qenë i dënuar më parë, rrethanat në të cilat janë kryer ato dhe pasojën e ardhur.

Me vendimin nr. ***, datë 23.11.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (gjyqtari i hetimeve paraprake) vendosi: *“Vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit ndaj shtetasit S. S., duke pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, rrethanat në të cilat janë kryer ato, pasojën e ardhur, si dhe ka qenë i dënuar 3 herë më parë dhe është përsëritës recedivist i posaçëm, veprën penale e ka shoqëruar me veprime dhune”.*

Me vendimin nr. ***, datë 23.12.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan vendosi sërish: *“Caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, parashikuar nga neni 238, duke pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, rrethanat në të cilat janë kryer ato, pasojën e ardhur, si dhe ka qenë i dënuar 3 herë më parë dhe është përsëritës recedivist i posaçëm, veprën penale e ka shoqëruar me veprime dhune”.*

Me kërkesën e paraqitur nga i pandehuri, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (subjekti i rivlerësimit, anëtar i trupës gjykuese) në datën 29.1.2016 vendosi: *“Zëvendësimin e masës së sigurisë “arrest me burg” në masë sigurimi “arrest në shtëpi”, parë në harmoni me situatën shëndetësore të të pandehurit, nevojat e sigurimit janë zbutur dhe nuk është evident rreziku i largimit të të pandehurit apo rreziku i marrjes së vërtetësisë ose manipulimi i provave”.*

Kërkuesi/i pandehuri bashkë me kërkesën ka paraqitur edhe epikrizën përkatëse shëndetësore me nr. 84 prot., datë 20.1.2016, që citon se: *“Shtetasi S. S. shpeshherë bëhet ankciroz, i gatshëm për t’u konfrontuar me të tjerë dhe të jetë vazhdimisht nën kontroll”.*

Në përfundim të hetimeve, në datën 19.1.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka paraqitur për gjykim kërkesën me objekt dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 2226/2015, me të pandehur shtetasin S. S. dhe deklarinin fajtor për kryerjen e veprave penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal dhe “kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 4.4.2016, vendosi: *“Deklarimin fajtor të shtetasit S. S. dhe deklarinin fajtor për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal dhe “kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal dhe bashkimin e dënimeve bazuar në nenin 55 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit e 6 muaj burg. Në zbatim të nenit 406/1 uljen e dënimit përfundimisht me një vit burg”.*

13.1.1. Nga sa më lart konstatohet se:

Dispozita e nenit 230/2 të Kodit të Procedurës Penale ndalon vendosjen e masës së sigurimit personal “arrest në burg” në kushtet kur personi ndodhet në një gjendje veçanërisht të rëndë.

Në rastin konkret sa më lart nuk duket të jetë e provuar. Situata shëndetësore e individit ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit personal duhet të certifikohet në rrugë procedurale nga ana e ekspertizës përkatëse shëndetësore, që duhet të konkludojë në terma të qartë në lidhje me vënien në rrezik të shëndetit nga zbatimi i masës së sigurimit personal. Sipas epikrizës së administruar në dosje, i pandehuri ka qenë duke u trajtuar pranë Qendrës Spitalore Elbasan dhe nuk rezulton që në informacionin përkatës, mjekët e këtij institucioni të kenë konstatuar një gjendje të rëndë apo rrezikim jete për shkak të zbatimit të masës së sigurimit të caktuar.

Sipas procesverbaleve të administruara në dosje, duket se procesi gjyqësor është zhvilluar në harkun kohor 29.1.2016 – 4.4.2016 (për një periudhë 4-mujore). Në nenin 342 të Kodit të Procedurës Penale është përcaktuar se kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasshme të punës. Gjykata lejohet ta ndërpresë shqyrtimin gjyqësor deri në 15 ditë, vetëm për raste të veçanta. Në procesverbal, trupi gjykues nuk argumenton arsyet e kësaj kohëzgjatjeje dhe shkaqet ligjore të saj.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti është në konflikt interesi me të pandehurin sipas neneve 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale për shkak të marrëdhënieve të punës së tij me kumatën dhe bashkëshorten e të pandehurit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me konfliktin qoftë edhe në dukje për shkak të marrëdhënieve të punësimit, për të cilin duhet të hiqte dorë nga gjykimi i çështjes së mësipërme sipas neneve 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me këto konstatime

13.1.2. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur: *“Ndryshe nga sa argumenton denoncuesi dhe Komisioni në pretendimet e tij, vlerësimi i gjykatës për zëvendësimin e masës së arrestit nuk është bërë vetëm mbi bazën e dokumentacionit mjekësor.*

Në zëvendësimin e masës gjykata ka marrë parasysh së pari parashikimet e nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se: “Arrestit me burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme...”

Në rastin objekt gjykimi faktet që janë marrë në konsideratë nga gjykata për ndryshimin e masës së sigurimit janë bazuar në nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale.

Analiza kumulative e gjendjes mjekësore dhe e përfundimit të hetimeve nga ana e Prokurorisë (pamundësisë së të pandehurit për të ndikuar në formimin e korpusit të provave të nevojshme për gjykimin e themelit të çështjes penale në ngarkim të tij), e parë në raport me rëndësinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e të pandehurit, në raport me domosdoshmërinë e mbajtjes së tij nën masën e sigurimit “arrest me burg”, me të drejtë e kanë çuar gjykatën në vlerësimin e ndryshimit të kësaj mase, me një masë më të përshtatshme, në përputhje me kushtet e parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230.

Praktika e punës në gjykatat e rretheve gjyqësore është që gjykimi i çështjeve penale, edhe në kushtet e gjykimit të pandërprerë, të kryhet me interval nga 10 - 15 ditë. Aq me tepër që në rastin objekt shqyrtimi gjykimi nuk realizohej nga një gjyqtar i vetëm, por nga një trupë prej 3 gjyqtarësh, të cilët për shkak të ngarkesës duhet të rakordonin për datën dhe orën e njëjtë të gjykimit.

Subjekti, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, vlerëson se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të neneve 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, mungesë që provohet edhe nga vendimi i fajësisë i dhënë nga subjekti në përfundim të shqyrtimit të themelit të çështjes penale, vendim i cili nuk është ankimuar nga Prokuroria dhe është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës”.

13.1.3 Arsyetimi ligjor

Trupi gjykues arsyeton se dispozita e nenit 230/2 të Kodit të Procedurës Penale ndalon vendosjen e masës së sigurimit personal “arrest në burg” vetëm në kushtet kur personi ndodhet në një gjendje veçanërisht të rëndë.

Në rastin konkret, arsyetimi, bazuar në nenin 230/2 të Kodit të Procedurës Penale, nuk mbështetet në provat e administruara, sipas të cilave i pandehuri ka qenë duke u trajtuar pranë Qendrës Spitalore Elbasan dhe nuk rezulton që, në informacionin përkatës, mjekët e këtij

institucioni të kenë konstatuar gjendje të rëndë apo rrezikim jete për shkak të zbatimit të masës së sigurimit të caktuar.

Masa e sigurisë e vendosur nuk është në përputhje edhe me nenin 229/2 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk mban në konsideratë rëndësinë e faktit dhe vazhdimësinë, përsëritjen dhe rrethanat rënduese lidhur me të pandehurin, parashikuar nga Kodi Penal.

I pandehuri, sipas dosjes së administruar, rezulton se ka qenë përsëritës, pasi ka qenë i dënuar tri herë para kryerjes së kësaj vepre penale, fakt ky që nuk u mbajt në konsideratë nga gjykata.

Në ndryshim nga pretendimet e subjektit, trupi gjykues vlerëson se sipas parashikimeve të nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale *arrestimi me burg në këtë rast legjitimohej jo vetëm nga kërkesa e Prokurorisë, por edhe nga rrezikshmëria e veçantë e të pandehurit, i akuzuar për “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal dhe “kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik”.*

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit në lidhje me konstatimin se procesi gjyqësor është zvarritur pasi, mbeten në nivel deklarativ, pasi në procesverbalet e seancave nuk argumentohen arsyet e kësaj kohëzgjatjeje dhe/apo shtyrja e seancave nuk bazohet në shkaqe të justifikuara ligjrisht. Gjykata lejohet ta ndërpresë shqyrtimin gjyqësor deri në 15 ditë, vetëm për raste të veçanta. Në nenin 342 të Kodit të Procedurës Penale është përcaktuar se kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë, gjykata vendos vazhdimin ditën e mëpasshme të punës.

Komisioni mbajti në konsideratë edhe vendimin nr. ***, datë 23.12.2015, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me një trup tjetër gjykues kishte vendosur *“Caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, parashikuar nga neni 238, të Kodit të Procedurës Penale duke arsyetuar mbi rrethanat rënduese dhe rrezikshmërinë e të pandehurit, të cilat nuk u morën në konsideratë nga trupi gjykues, ku në përbërje ishte edhe subjekti i rivlerësimit.*

Sa i takon deklarimeve të subjektit se ai nuk është në konflikt interesi me të pandehurin sepse e ka dënuar atë, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk paraqiti asnjë provë, për sa iu kërkuar për të provuar, nëse për shkak të njohjes prej marrëdhënieve të punës me kunatën dhe bashkëshorten e të pandehurit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit për të cilin duhet të hiqte dorë nga gjykimi i çështjes së mësipërme.

Lloji i vendimmarrjes, shpjeguar nga subjekti, në vlerësim të trupit gjykues nuk përjashton subjektin e rivlerësimit nga detyrimi ligjor për heqjen dorë prej shqyrtimit të kësaj çështjeje.

13.2 Lidhur me vendimin penal nr. ***

Denoncuesi, në lidhje me këtë vendim, denoncon se:

Subjekti i rivlerësimit është caktuar pa short elektronik të rregullt. Subjekti zvarriti gjykimin derisa shpalli vendimin që ta ndihmonte të pandehurin me masë dënimi. Subjekti e ndihmoi të pandehurin edhe me masë dënimi, megjithëse kishte rrezikshmëri shoqërore të madhe sepse kishte kryer tri vepra penale.

Vendimi ka mangësi dhe dobësi në analizën dhe argumentimin e bindshëm e logjik të qëndrimit të tij për cilësimin ligjor të veprës penale, si dhe nuk ka çmuar provat dhe vlerën e tyre konform nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan vendosi në dispozicion vendimin nga ku rezultoi se:

Në datën 17.12.2011, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan vendos regjistrimin e procedimit penal nr. ***, pa autor për kryerjen e veprave penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal dhe “vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76-11 të Kodit Penal. Në datën 6.2.2012, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan vendos regjistrimin e emrit të shtetasit V. B. si person që i atribuohet veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal dhe “plagosje e

rendë”, pasi në datën 28.9.2012 është vendosur pushimi i pjesshëm i këtij procedimi në lidhje me vdekjen e viktimës për shkak të mjekimit të pakujdesshëm të tij.

Në datën 3.10.2012 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan merr vendim për dërgimin për gjykim të procedimit penal në ngarkim të të pandehurit V. B., i akuzuar për kryerjen e veprave penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal, “plagosje e rendë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme” neni 88/b i Kodit Penal, si dhe “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kërkuar: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit, shtetasit V. B., për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe dënimin e tij me një vit burgim, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal dhe “plagosje e rendë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, neni 88/b i Kodit Penal dhe dënimin me 2 vjet dhe 9 muaj dhe “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe dënimin me 3 muaj”.*

Në datën 12.11.2012, me vendimin nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, referuar rrethanave të tilla si rrezikshmëria e të pandehurit, shkalla e fajit, mosha dhe personaliteti i tij, pozita familjare, rrethanat e kryerjes së veprës penale qenien prezent të rrethanave lehtësuese të përcaktuara në nenet 48/ç, dh, 48/e dhe 49 të Kodit Penal – ka çmuar se masa e dënimit duhet të jetë me e butë dhe ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të shtetasit V. B. për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, “plagosje e rendë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, neni 88/b i Kodit Penal dhe “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe bashkimin e dënimeve dhe dënimin përfundimisht me 1 vit e 9 muaj burg dhe në zbatim të nenit 406/1 dënimin e tij përfundimisht me 1 vit e 2 muaj burgim”.*

13.2.1 Nga sa më lart konstatohet se:

Në vendim subjekti duket se nuk ka zbatuar drejt nenin 48 të Kodit Penal, më konkretisht: *“Shkronjën “dh” sipas së cilës përbën rrethanë lehtësuese kur personi paraqitet në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale, pasi nga aktet e administruara në dosje nuk provohet që personi është paraqitur me vullnetin e tij të lirë në organet kompetente.*

Një ndër kërkesat që duhet të plotësohet që të jemi përpara kësaj rrethane lehtësuese është që personi të paraqitet në organin kompetent para se të jetë zbuluar që ai është autor i dyshuar i veprës penale dhe para se t’i jetë bërë thirrje nga organet kompetente. Përkundrazi, në rastin konkret, i pandehuri është regjistruar si person që i atribuohet vepra penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, bazuar në veprimet hetimore të organit të akuzës 3 muaj pas regjistrimit të procedimit penal.

Gjithashtu, referuar edhe procesverbalit të marrjes së të dhënave nga personat që tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit datë 30.7.2012, administruar në dosje, babai i autorit ka deklaruar se autori nuk tregonte për ngjarjen dhe ai e ka marrë vesh vetëm pas disa muajsh përfshirjen e djalit në një sherr.

Në vendim subjekti duket se nuk ka zbatuar drejt nenin 48 të Kodit Penal, më konkretisht, shkronjën “e” kur ka arsyetuar se marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar. Neni 48 i Kodit Penal, në shkronjën “e” *kërkon që normalizimi i marrëdhënieve të realizohet ndërmjet autorit të veprës penale dhe viktimës.*

Sipas deklarimeve të familjarëve të viktimës, administruar në dosje, rezulton se kanë qenë familjarët që kanë kërkuar normalizimin e marrëdhënieve dhe jo autori i veprës penale.

Sa më sipër, subjektit iu kërkuar të japë shpjegime lidhur me këto konstatime.

13.2.2. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Konstatimi i Komisionit për relatimin e rrethanës lehtësuese të personit që paraqitet në organet kompetente*

pas kryerjes së veprës penale është i pasaktë, pasi kjo rrethanë është vlerësuar së bashku me të gjitha rrethanat e tjera në vendimin gjyqësor ndaj të pandehurit Viktor Bella.

Në rrethanat lehtësuese që janë vlerësuar nga subjekti gjatë gjykimit të çështjes janë rrezikshmëria e veprës penale, rrezikshmëria e autorit, shkalla e fajit, pozita shoqërore, mosshmangia ndaj hetimit, pohimet që ndihmojnë në zbardhjen e ngjarjes, pendimi, normalizimi i marrëdhënieve, moshë e re, personaliteti, mungesa e precedentëve penale etj.

Është tërësia e këtyre rrethanave lehtësuese ajo që ka çuar në krijimin e bindjes së brendshme të gjykatës që në rastin objekt shqyrtimi masa e dënimit duhet të ishte më e butë se ajo e kërkuar nga Prokuroria.

Vendimi i gjykatës nuk është kundërshtuar nga asnjë nga palët ndërgjyqëse çka provon se as prokuroria as i pandehuri nuk kishin kundërshtime me vlerësimin dhe vendimmarrjen”.

13.2.3. Arsyetimi ligjor

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, vlerëson se:

Aplikimi i nenit 48, shkronja “dh” e Kodit Penal, kërkon që personi të jetë paraqitur me vullnetin e tij të lirë në organet kompetente, para se të zbulohet si autor i dyshuar i veprës penale dhe para thirrjes nga organet kompetente, për sa i pandehuri ishte regjistruar si person që i atribuohet vepra penale bazuar në veprimet hetimore të organit të akuzës.

Aplikimi i nenit 48, shkronja “dh” e Kodit Penal, kërkon normalizimin ndërmjet autorit të veprës penale dhe viktimës ose trashëgimtarëve të saj, si dhe nga gjykimi ka rezultuar se kanë qenë familjarët e të pandehurit që kanë kërkuar normalizimin e marrëdhënieve dhe jo autori i veprës penale.

Arsyetimi i bërë nga subjekti pas kalimit të barrës së provës se në vendimin gjyqësor u morën parasysh rrethanat e tjera nuk është përputhje me faktet dhe rrethanat që janë provuar gjatë procesit gjyqësor, nga të cilat jo vetëm nuk provohet se plotësohen rrethanat lehtësuese, por provohet se i pandehuri gjendet në aplikimin e nenit 50, shkronjës “i” të Kodit Penal.

Rrezikshmëria e autorit, rrezikshmëria e veprës penale dhe shkalla e fajit, arsyetuar nga subjekti si rrethanat lehtësuese, nuk mbështeten nga sa ka rezultuar se ai akuzohet për kryerjen e veprave penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, “plagosje e rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme” dhe “kanosje”, vepra për të cilat nga organi i akuzës u kërkua dënimi me 4 vjet burgim.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se arsyetimi i këtij vendimi nuk është bërë në përputhje me provat e administruara dhe pa marrë parasysh rrethanat rënduese.

Komisioni vlerëson të nënvizojë edhe sa gjatë hetimit administrativ, sipas të dhënave të sistemit TIMS, rezultoi se subjekti ka përdorur automjetin në pronësi të këtij shtetasi, V. B., pasi ka gjykuar këtë çështje penale, duke i vlerësuar rrethanat dhe procedurat në vlerësimin tërësor sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

13.3 Lidhur me vendimin penal nr. ***

Denoncuesi, në lidhje me këtë vendim, denoncon se:

Subjekti i rivlerësimit është caktuar pa short elektronik të rregullt me qëllim favorizimin e palës. Favorizoi kërkuesin pasi shkeli procedurat e gjykimit.

Vendimi ka mangësi dhe dobësi në analizën dhe argumentimin e bindshëm e logjik të qëndrimit të tij për cilësimin ligjor të veprës penale, ka mungesë të shprehjes në mënyrë të qartë, pasi nuk ka çmuar provat dhe vlerën e tyre konform nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan vendosi në dispozicion vendimin nga ku rezultoi se:

Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2015.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal me nr. *** për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”. Ka rezultuar se personi nën hetim A. T. ka depozituar në bankë shumën 100.000 euro dhe më pas i ka transferuar në llogarinë e shtetasit P. Ç., me përshkrimin “Shlyerje e kontratës së shitjes datë 6.8.2015”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 13.8.2015, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Vendosjen e masës së sigurimit pasuror, sekuestros preventive për llogarinë bankare nr. ***, llogari bankare në euro në emër të shtetasit P. Y. Ç., ndodhur në bankën e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë “Alpha Bank”*”.

Kërkuesi Petrit Çela në vijim i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan revokimin e masës sekuestro preventive mbi llogarinë e tij bankare.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 10.9.2015, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit P. Ç. dhe revokimin e vendimit administrativo-penal nr. ***, datë 13.8.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, sa i përket vendosjes së masës së sigurimit pasuror, sekuestros preventive, për llogarinë bankare në euro në emër të shtetasit P. Y. Ç. në bankën “Alpha Bank”, duke urdhëruar heqjen e masës së sigurimit.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. *** (***), datë 1.10.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. *** (***), datë 10.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kundër vendimit të mësipërm Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës ka ushtruar rekurs në datën 30.10.2015.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 13.1.2016, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. *** (***), datë 1.10.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të vendimit nr. *** (***), datë 10.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuesit P. Ç., duke arsyetuar si vijon:*

*“Vendimi nr. ***, datë 1.10.2015, i Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimi nr. ***, datë 10.9.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, janë rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal e, si të tillë, duhet të prishen duke u vendosur rrëzimi i kërkesës së kërkuesit P. Ç. Referimi që i kanë bërë gjykatat është i gabuar, kjo dispozitë nuk zbatohet për masat e sigurimit pasuror.*

Masat e sigurimit pasuror parashikohen në një kre të veçantë të Kodit të Procedurës Penale, kreu VI, nenet 270-276 të tij, i ndarë në dy seksione, seksioni mbi sekuestron konservative dhe seksioni II mbi sekuestron preventive, masë e cila është vendosur ndaj kërkuesit P. Ç. në çështjen objekt shqyrtimi.

Pikërisht, për këtë shkak, duke qenë se në rastin konkret, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ndaj kërkuesit është vendosur sekuestroja preventive sipas nenit 274 të këtij Kodi, nuk mund të revokohet ajo bazuar në nenin 260 të Kodit të Procedurës Penale. Rastet se kur e humbet fuqinë kjo masë, kur shfuqizohet apo ndryshohet ajo, janë të përcaktuar literalisht në nenet 275 dhe 276 të Kodit të Procedurës Penale.

Përkatësisht, sekuestroja preventive e humbet fuqinë (neni 275 i Kodit të Procedurës Penale) kur ka marrë formë të prerë vendimi i pafajësisë apo i pushimit të çështjes. Pra, Gjykata, në vendimin përfundimtar që e zgjidh çështjen penale përkatëse, disponon dhe mbi këtë masë duke urdhëruar konfiskimin ose kthimin atij që i takojnë; sekuestroja preventive e vënë nga shkalla e parë mund të shfuqizohet, ndryshohet (neni 276 i Kodit të Procedurës Penale) vetëm nga

Gjykata e Apelit kur ajo është vënë në lëvizje me ankim ndaj vendimit dhe jo me kërkesë për revokim apo zëvendësim mase.

Pra, në rastin e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive, Kodi i Procedurës Penale nuk njeh konceptin e revokimit, por atë të heqjes së saj, sipas nenit 274/3 të tij, i cili parashikon se: “Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit ose të interesuarit, e heq sekuestron”.

Çka do të thotë se gjykata në këto raste mund të disponojë heqjen e masës së sigurimit, bazuar në nenin 274/3 të Kodit të Procedurës Penale dhe jo revokimin e masës së sigurimit në bazë të nenit 260 të po këtij Kodi””.

13.3.1. Subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me sa:

Sipas vendimit të Gjykatës së Lartë vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është i pabazuar në prova, në zbatim të gabuar të ligjit penal material dhe të atij procedural dhe në kundërshtim me kriteret e Kodit të Procedurës Penale dhe provat që janë administruar në gjykim.

Në rastin konkret është proceduar me masë sigurimi pasuror sipas kriterëve të përcaktuara në nenet 270-274 të Kodit të Procedurës Penale dhe jo përpara një mase sigurimi ndaluese apo shtrënguese për të cilën duhet proceduar sipas nenit 260/2 të po këtij Kodi.

Nga analizimi i akteve në dosje nuk administrohet akti i shortit elektronik për caktimin e subjektit në cilësinë e gjyqtarit të çështjes.

Subjekti duhet të shpjegojë arsyetimin për cilësimin ligjor të veprës penale, çmuarjen e provave dhe vlerën e tyre konform nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale.

13.3.2. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: “Konstatimi i bërë nga Komisioni se vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është i pabazuar në prova nuk gjendet në vendimin e Gjykatës së Lartë. Vendimi i Gjykatës së Lartë përcakton se: vendimi i Gjykatës së Apelit dhe i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan janë rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal e, si të tillë, duhet të prishen.

Nëse gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk do të kishin në asnjë rast interpretime të gabuara të ligjit, atëherë do të ishte i panevojshëm organizmi i sotëm i sistemit gjyqësor. Fakti që të dyja gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë bërë të njëjtin vlerësim dhe interpretim të ligjit procedural dhe vetëm kur çështja i është nënshtruar për gjykim Gjykatës së Lartë, kjo e fundit ka konstatuar që interpretimi i gjykatave të shkallëve më të ulëta ka qenë i gabuar tregon që vendimmarrja e subjektit, ndonëse e konstatuar më pas e gabuar nuk është e qëllimshme.

Në rastin konkret duhet marrë parasysh edhe mungesa e praktikës gjyqësore në lëmin e të drejtës administrative penale çka penalizon edhe mënyrën e gabuar të interpretimit nga gjykata e shkallëve më të ulëta.

Edhe një herë Komisioni referon gabim nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me vlerësimin e provave, pasi në rastin konkret, sikurse citon edhe Gjykata e Lartë, interpretimi i gabuar lidhet me dispozitën procedurale dhe jo me provat në gjykim”.

Subjekti paraqiti në cilësinë e provës vendimin nr. ***, datë 10.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

13.3.3. Arsyetimi ligjor

Komisioni e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konstatimi i bërë nga Komisioni se vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është i pabazuar në prova dhe ligj nuk gjendet në vendimin e Gjykatës së Lartë, nuk qëndron, pasi në faqen 4 të vendimit referohet se: “Ky Kolegj vëren se qëndrimi i mbajtur nga të dyja gjykatat, në lidhje me pranimin e

kërkesës së kërkesit P. Ç. me objekt revokimin e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive, është i pabazuar në prova e në ligj”.

Trupi gjykues, në vlerësimin e vendimmarrjes së subjektit në këtë rast, vlerëson se:

Shuma e pretenduar nga kërkesi, për të cilën është vendosur sekuestroja preventive, është sekuestruar në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2015, për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, formë e kryerjes së të cilës është edhe këmbimi ose transferimi, si para të paguara dhe të pajustificuara prej këtij të fundit dhe, si të tilla, ato janë ende objekt hetimi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. ***, datë 13.8.2015, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Vendosjen e masës së sigurimit pasuror, sekuestros preventive për llogarinë bankare në euro, në emër të shtetasit P. Y. Ç., në bankën e nivelit të dytë “Alpha Bank”, bazuar në nenet 274 e vijues të Kodit të Procedurës Penale”.*

Me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 13.8.2015, ndaj kërkesit është vendosur sekuestroja preventive sipas nenit 274 të këtij Kodi. Në këtë rast, sekuestroja preventive e vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan do ta humbiste fuqinë vetëm kur të merrte formë të prerë vendimi i pafajësisë apo i pushimit të çështjes.

13.4. Lidhur me vendimin civil nr. ***

13.4.1. Denoncuesi, në lidhje me këtë vendim civil, referon se:

Subjekti i rivlerësimit është caktuar pa short elektronik të rregullt.

Vendimi ka mangësi dhe dobësi në analizën dhe argumentimin e bindshëm e logjik të qëndrimit të tij, ka mungesë të shprehjes në mënyrë të qartë, nuk gjenden analizë e të gjitha fakteve që kanë rezultuar prej gjykimit të çështjes.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan vendosi në dispozicion vendimin nga ku rezultoi se:

- Në datën 26.1.2010 subjekti i rivlerësimit është caktuar në cilësinë e gjyqtarit të çështjes civile me short. Nga shqyrtimi i dosjes civile rezulton se paditësi O. M. ka paraqitur padi kundër të paditurit Drejtoria sh.a., ***, Elbasan, me objekt “Përmbushja e detyrimit kontraktor nga pala e paditur” (aktmarrëveshje e datës 20.6.2002 me palën e paditur).

- Në datën 19.3.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të çështjes), me vendimin nr. ***, vendosi: *“Pranimin e kërkesëpadisë së paditësit O. M. dhe detyrimin e të paditurit Drejtoria sh.a. ***, Elbasan, të përmbushë detyrimin kontraktor (aktmarrëveshje e datës 20.6.2002 me palën e paditur)”.*

Çështja është regjistruar për gjykim në datën 26.1.2010 dhe vendimi është dhënë në datën 19.3.2010. Kundër vendimit të gjykatës ka bërë ankim pala e paditur në Gjykatën e Apelit Durrës.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 1.6.2010, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit civil nr. *** dhe rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit O. M., si të pabazuar në ligj e në prova”.* Vendimi i Gjykatës së Apelit u la në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 1.10.2013.

13.4.2. Nga analizimi i vendimit konstatohet se:

Vendimi nr. ***, datë 1.6.2010, i Gjykatës së Apelit Durrës, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit civil nr. ***, dhënë nga ju në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, pasi nuk është i bazuar në ligj e në prova e, si i tillë, bazuar në nenin 466, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Civile, duhet ndryshuar”.*

Subjektit iu kërkua të shpjegojë arsyetimin për cilësimin ligjor dhe çmuarjen e provave.

13.4.3. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka dhënë shpjegime lidhur me arsyetimin për cilësimin ligjor të veprës penale dhe çmuarjen e provave.

13.4.4. Arsyetimi ligjor

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 234, datë 1.6.2010, vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, ka vlerësuar se vendimi civil nr. ***, dhënë nga subjekti, nuk është i bazuar në ligj e në prova.

Nuk provohet ligjshmëria e nje aktmarrëveshje, e cila nuk ka as formën dhe as bazën ligjore të nevojshme për të kryer një veprim juridik të kësaj natyre. Në momentin e lidhjes së aktmarrëveshjes, as paditësi dhe as i padituri nuk provojnë se kanë qenë pronar të sendeve, për të cilat kanë parashikuar të “shkëmbejnë” në të ardhmen.

13.5. Lidhur me vendimin penal nr. *, viti 2019**

13.5.1 Denoncuesi, në lidhje me këtë vendim, referon se:

Subjekti i rivlerësimit ka përcaktuar masat e sigurimit në kundërshtim me provat dhe kriteret e Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi ka mangësi dhe dobësi në analizën dhe argumentimin e bindshëm e logjik të qëndrimit të tij për cilësimin ligjor të veprës penale, ka mungesë të shprehjes në mënyrë të qartë, pasi nuk ka çmuar provat dhe vlerën e tyre konform nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale.

Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan vendosi në dispozicion kopje të dosjes penale me nr. ***.

Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se në datën 4.1.2019 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan vendosi regjistrimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”.

Në datën 12.4.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar në cilësinë e personave që i atribuohet vepra penale shtetasve A. Q., L. Gj. dhe L. D. për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe shtetasi S. P. për veprat penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” dhe “shfrytëzim i prostitucionit”, parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 14.4.2014, kërkoi vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në flagrancë dhe caktimin si masë sigurimi personal “arrest me burg” për shtetasit A. Q., L. Gj. dhe L. D. për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

Në datën 16.4.2019, me vendimin nr. ***, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, vendosi: *“Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit në flagrancë dhe caktimin si masë sigurimi personal “arrest me burg” për shtetasit A. Q., L. Gj. dhe për shtetasin L. D. masën e sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, duke mbajtur parasysh gjendjen e provave për të ndaluarin dhe që nuk paraqet rrezikshmëri të veçantë, si dhe i ndaluari ka vetëm një kontakt me shtetasin S. P., pranuar dhe vetë nga organi i akuzës”.*

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 8.5.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 16.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në këtë mënyrë: *“Zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” në “arrest në burg”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, për personin nën hetim L. D.”.*

13.5.2 Nga analizimi i vendimit konstatohet se:

Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, vendosur nga subjekti i rivlerësimit për të dyshuarin L. D., nuk është i bazuar në prova e fakte pasi:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 4.1.2019, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, bazuar në informacionin e seksionit për hetimin e narkotikëve dhe trafikeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, sipas të cilit disa persona banorë të këtij qyteti ushtrojnë aktivitetin kriminal të shpërndarjes së lëndës narkotike, lloji kokainë.

Në kuadër të këtij procedimi janë përdorur metoda speciale si përgjime, vëzhgime, veprime të stimuluar ndërmjet agjentëve të policisë gjyqësore, ndërmjet shtetasve K. Gj., L. D., K. T., A. Q. dhe L. Gj.

Gjykata, në dhënien e këtij vendimi, duket se nuk ka mbajtur parasysh nenin 230, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, pasi i pandehuri rezulton të ketë konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, që parashikon burgim jo më pak në maksimum se 10 vjet.

Vepra penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal është një vepër e përhapur dhe që paraqet rrezikshmëri shoqërore.

Subjektit iu kërkua të shpjegojë analizën dhe argumentimin e bindshëm e logjik të qëndrimit të tij për cilësimin ligjor të veprës penale, çmuarjen e provave dhe vlerën e tyre konform nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale.

13.5.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Nga provat e paraqitura në gjykim nga ana e organit të prokurorisë rezulton se shtetasi L. D. ka pasur vetëm një kontakt me shtetasin S. P., gjatë të cilit nuk është vëzhguar dhe dokumentuar shkëmbimi apo posedimi i lëndëve narkotike. Për arritjen e konkluzionit se për të pandehurin L. D. masa e përshtatshme e sigurimit personal ishte ajo e detyrim paraqitjes, subjekti ka vlerësuar se, ndonëse i ndaluar, dyshohet për një vepër penale që parashikon si lloj dënimi vetëm atë me burgim, vetë personi nuk paraqet rrezikshmëri të veçantë shoqërore. Njëkohësisht është vlerësuar personaliteti i të pandehurit, gjendja e tij shoqërore, si dhe në veçanti gjendja e provave të grumbulluara deri në atë fazë të hetimit nga organi procedues. Në çmimin e brendshëm të subjektit, në momentin e marrjes së vendimit për caktimin e masës së sigurimit personal ajo e detyrimit të paraqitjes në policinë gjyqësore ishte masa më e përshtatshme për të pandehurin L. D. Rezulton se në datën 29.7.2019 subjekti ka disponuar me vendim për rrëzimin e kërkesës për ndryshimin e masës së sigurimit personal të caktuar nga Gjykata e Apelit Durrës në ngarkim të shtetasit L. D., sipas vendimit bashkëlidhur”.*

Subjekti paraqiti në cilësinë e provës vendimin nr. ***, datë 16.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 8.5.2019, ka vendosur ndryshimin dhe caktimin si masë sigurimi “arrest me burg” ndaj të dyshuarit L. D.

13.5.4 Arsyetimi ligjor

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, çmon se vendimi i subjektit nuk bazohet në provat e administruara në dosje.

Masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” e vendosur nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore për të dyshuarin L. D. nuk pajtohet me kërkesat e nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale, pasi vepra penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal është një vepër që paraqet rrezikshmëri shoqërore, dhe marzhi i dënimit që parashikohet për këtë vepër është me burgim nga 5 deri në 10 vjet.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit lidhur me këtë vendim, është gjetur në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material dhe procedural.

Konkluzioni lidhur me denoncimin

Trupi gjykues çmon se vendimet gjyqësore objekt vlerësimi, sa më sipër referuar nga denoncimi, merren në konsideratë dhe vlerësohen në drejtim të mungesës së analizës ligjore dhe argumentimit, sikundër Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në vendimin orientues (JR) 21/2019, shprehet se: “[...] konsideron me rëndësi që për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t’i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku [...], kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016”.

Sa më sipër, gjetjet lidhur me vendimet e analizuara referuar denoncimit të administruar sipas nenit 53 konsiderohen të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatores së çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin e tij ligjor në seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura, në vlerësimin e çështjes në tërësi,

(I) arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z.Taulant Tafa, në kuptim të parashikimeve të pikave 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” “b” dhe “c” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën totale prej -11.081.455 lekësh për periudhën e deklarimit; ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në momentin e krijimit; është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit; ka mosdeklarim të ardhurash në deklaratën Vetting,

(II) arrin në përfundimin se në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave, subjekti i rivlerësimit, z.Taulant Tafa, ka cënuar besimin e publikut te drejtësia në kuptim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Taulant Tafa, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 24.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues/Kundër

Xhensila PINE
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana